



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 9 janar 2026
Nr. ref.: AGJ 2935/26

AKTGJYKIM

në

**rastet nr. KO246/24, KO247/24, KO248/24, KO249/24, KO250/24, KO251/24,
KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24,
KO259/24 dhe KO260/24**

Parashtrues

Dymbëdhjetë (12) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Kuvendit
të Republikës së Kosovës që ndërlidhen me miratimin e pesëmbëdhjetë (15) ligjeve
në seancat e 5 dhjetorit 2024**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesave

1. Kërkesat KO246/24, KO247/24, KO248/24, KO249/24, KO250/24, KO251/24, KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24, KO259/24 dhe KO260/24, janë dorëzuar nga Mërgim Lushtaku, Hajdar Beqa, Abelard Tahiri, Ganimete Musliu, Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra, Rashit Qalaj, Isak Shabani, Ardian Kastrati, Ferat Shala, Bekim Haxhiu dhe Floretë Zejnullahu, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Kuvendi), nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejshmë: parashtruesit e kërkesave).

Vendimet e kontestuarra

2. Parashtruesit e kërkesave KO246/24-KO260/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e vendimeve si në vijim:

- (i) Parashtruesit e kërkesës KO246/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-801] dhe Vendimit [Nr. 08-V-848] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave (në tekstin e mëtejme: Ligji për Shërbimet e Pagesave);
- (ii) Parashtruesit e kërkesës KO247/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-806] dhe Vendimit [Nr. 08-V-854] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport (në tekstin e mëtejme: Ligji kundër dukurive negative në sport);
- (iii) Parashtruesit e kërkesës KO248/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-850] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatën Administrative);
- (iv) Parashtruesit e kërkesës KO249/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-800] dhe Vendimit [Nr. 08-V-847] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejme: Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit);
- (v) Parashtruesit e kërkesës KO250/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-802] dhe Vendimit [Nr. 08-V-849] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore (në tekstin e mëtejme: Ligji për provimin e maturës shtetërore);
- (vi) Parashtruesit e kërkesës KO251/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-822] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 07/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut (në tekstin e mëtejme: Ligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut);
- (vii) Parashtruesit e kërkesës KO252/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-795] dhe Vendimit [Nr. 08-v-842] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-315 për Banim Social dhe të Përballueshëm (në tekstin e mëtejme: Ligji për Banim Social dhe të Përballueshëm);
- (viii) Parashtruesit e kërkesës KO253/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-797] dhe Vendimit [Nr. 08-V-845] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (në tekstin e mëtejme: Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim);
- (ix) Parashtruesit e kërkesës KO254/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-796] dhe Vendimit [Nr. 08-V-843] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në tekstin e mëtejme: Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor);
- (x) Parashtruesit e kërkesës KO255/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-807] dhe Vendimit [Nr. 08-V-855] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin

- e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale (në tekstin e mëtejme: Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale);
- (xi) Parashtruesit e kërkesës KO256/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-805] dhe Vendimit [Nr. 08-V-853] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore);
 - (xii) Parashtruesit e kërkesës KO257/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-804] dhe Vendimit [Nr. 08-V-851] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore);
 - (xiii) Parashtruesit e kërkesës KO258/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-803] dhe Vendimit [Nr. 08-V-852] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore);
 - (xiv) Parashtruesit e kërkesës KO259/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-799] dhe Vendimit [Nr. 08-V-846] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare XXI Prishtina 2030 (në tekstin e mëtejme: Ligji për Lojërat Mesdhetare);
 - (xv) Parashtruesit e kërkesës KO260/24 kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit [Nr. 08-V-821] të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat (në tekstin e mëtejme: Ligji për Bankat).

Objekti i çështjes

- 3. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të Kuvendit të përshkruara si më lart. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se (i) vendimet e Kuvendit që ndërlidhen me kërkesat KO246/24, KO247/24, KO249/24, KO250/24, KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24 dhe KO259/24 nuk janë në përputhshmëri me nenet 74 [Ushtrimi i Funksionit], 76 [Rregullorja e Punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), ndërkah (ii) vendimet e Kuvendit që ndërlidhen me kërkesat KO248/24, KO251/24 dhe KO260/24 nuk janë në përputhshmëri me nenet 74 [Ushtrimi i Funksionit] dhe 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës.
- 4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesave kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme ndaj vendimeve të kontestuara të Kuvendit, për të pezulluar *ex lege* dërgimin për dekretim dhe publikim, deri në vendosjen përfundimtare për kërkesat nga Gjykata.

Baza juridike

- 5. Kërkesat bazohen në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me

paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.
7. Më 13 dhjetor 2024, parashtruesit e kërkesave KO246/24, KO247/24, KO248/24, KO249/24, KO250/24, KO251/24, KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24, KO259/24 dhe KO260/24 dorëzuan kërkesat në Gjykatë.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata i njoftoi për regjistrimin e kërkesave (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit, të cilit iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe (iii) Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit (në tekstin e mëtejshëm: zv. Sekretari i Kuvendit), me sqarimin që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 (Afati) të Ligjit *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Gjykata, bazuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit dhe praktikën e saj gjyqësore, rikujtoi se kjo dispozitë nënkupton që Ligji i kontestuar nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi ose të prodhojë efekte ligjore deri në vendimin final të Gjykatës, lidhur me çështjen e ngritur pranë saj. Presidentes dhe Kryetarit të Kuvendit iu kërkuar që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 30 dhjetor 2024 ndërsa zv. Sekretarit të Kuvendit iu kërkuar që t'i dorëzojë Gjykatës të gjitha dokumentet relevante lidhur me vendimet e kontestuar.
9. Më 19 dhjetor 2024, Kryetarja, në pajtim me paragrafin 3 të rregullit 32 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [KO246/24, KO247/24, KO248/24, KO249/24, KO250/24, KO251/24, KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24, KO259/24 dhe KO260/24], urdhëroi bashkimin e kërkesave të lartcekura me kërkesën KO246/24. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, zbatohet vendimi për gjyqtarin raportues dhe përbërjen e Kolegjit shqyrtues për kërkesën KO246/24.
10. Më 26 dhjetor 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO246/24], caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues, si dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO246/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Radomir Laban dhe Enver Peci (anëtarë).

11. Më 27 dhjetor 2024, Zv. Sekretari i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin e kërkuar.
12. Më 30 dhjetor 2024, Gjykata i njoftoi për bashkimin e kërkesave dhe Urdhrin për bashkim të tyre: (i) Presidenten; (ii) Kryetarin e Kuvendit; dhe (iii) Zv. Sekretarin e Kuvendit. Në të njëjtën ditë, Gjykata i njoftoi për regjistrimin dhe Urdhrin për bashkim të kërkesave: (i) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (ii) Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit); dhe (iii) parashtruesit e kërkesave, duke i njoftuar se mund të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 14 janar 2025.
13. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatis) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
14. Në të njëjtën ditë, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 15 janar 2025, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! kërkoj nga Gjykata shtyrjen e afatit për komente, me arsyetimin se të njëjtit, realisht, ishin njoftuar për mundësinë e paraqitjes së komenteve më 15 janar 2025 pasi shumica e stafit ishte në pushim si rezultat i përfundimit të sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit dhe festave të fundvitit. Përmes kërkesës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! kërkoj shtyrjen e afatit për paraqitje të komenteve deri më 20 janar 2025.
16. Më 17 janar 2025, Gjykata njoftoi Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për miratimin e kërkesës për shtyrjen e afatit për komente, duke u kërkuar që komentet e tyre t'i dorëzojnë në Gjykatë më së voni deri më 20 janar 2025.
17. Më 20 janar 2025, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! dorëzoi në Gjykatë komentet e tyre lidhur me rastin.
18. Më 28 janar 2025, Gjykata njoftoi për komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!: (i) Presidenten; (ii) Kryeministrin; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Avokatin e Popullit; (v) Zv. Sekretarin e Kuvendit; dhe (vi) parashtruesit e kërkesave.
19. Më 23 maj 2025, Gjykata pasi shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues, vendosi që shqyrtimin e tij ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
20. Më 15 korrik 2025, Gjykata shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që shqyrtimin e tij ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
21. Më 12 nëntor 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që kërkesa të shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi, më pesë (5) vota për dhe dy (2) kundër që: (i) Vendimet [Nr. 08-V-801] dhe [Nr. 08-V-848] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave; (ii) Vendimet [Nr. 08-V-806] dhe [Nr. 08-V-854] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.

o8/L-326 kundër dukurive negative në sport; (iii) Vendimet [Nr. 08-V-800] dhe [Nr. 08-V-847] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; (iv) Vendimet [Nr. 08-V-802] dhe [Nr. 08-V-849] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore; (v) Vendimet [Nr. 08-V-795] dhe [Nr. 08-v-842] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-315 për Banim Social dhe të Përballueshëm; (vi) Vendimet [Nr. 08-V-797] dhe [Nr. 08-V-845] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (vii) Vendimet [Nr. 08-V-796] dhe [Nr. 08-V-843] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; (viii) Vendimet [Nr. 08-V-807] dhe [Nr. 08-V-855] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale; (ix) Vendimet [Nr. 08-V-805] dhe [Nr. 08-V-853] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; (x) Vendimet [Nr. 08-V-804] dhe [Nr. 08-V-851] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore; (xi) Vendimet [Nr. 08-V-803] dhe [Nr. 08-V-852] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore; dhe (xii) Vendimet [Nr. 08-V-799] dhe [Nr. 08-V-846] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare, nuk janë në përputhshmëri me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe njëzëri vendosi që: (i) Vendimi [Nr. 08-V-821] i 5 dhjetorit 2024 i Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat; (ii) Vendimi [Nr. 08-V-822] i 5 dhjetorit 2024 i Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 07/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; dhe (iii) Vendimi [Nr. 08-V-850] i 5 dhjetorit 2024 i Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative; që të gjitha, janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 74 [Ushtrimi i funksionit] dhe 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përmbledhja e fakteve

22. Në vijim, Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës që i posedon, do të paraqesë, për aq sa është e mundur, në mënyrë të përmbledhur dhe bashkërisht faktet lidhur me procedurën që rezultoi në miratimin e Vendimeve të kontestuarra të Kuvendit. Në këtë drejtim, përmbledhja e fakteve do të pasqyrohet në mënyrë kronologjike, sipas kohës së mbajtjes së seancave të Kuvendit të 5 dhjetorit 2024.
23. Nga shkresat e lëndës rezulton se:
 - (i) në seancën plenare të Kuvendit të orës 10:00 u miratuan në parim Projektligji për Banim Social dhe të Përballueshëm, Projektligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat u miratuan pas leximit të dytë në seancën e Kuvendit të orës 14:40;

- (ii) në seancën e Kuvendit të orës 17:18: (i) pas leximit të dytë u miratuan Projektligji për Bankat dhe Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; ndërkaq po ashtu (i) u shqyrtuan dhe miratuan në parim Projektligji për Lojërat Mesdhetare, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Projektligji për Shërbimet e Pagesave, Projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore, Projektligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore, Projektligji për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, Projektligji kundër dukurive negative në sport dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale;
 - (iii) në seancën e Kuvendit të orës 19:30, pas leximit të dytë, u miratuan Ligji për Lojërat Mesdhetare, Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Ligji për Shërbimet e Pagesave dhe Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore;
 - (iv) në seancën e Kuvendit të orës 20:10 pas leximit të dytë, u miratua Ligji për Gjykatën Administrative; dhe
 - (v) në seancën e Kuvendit të orës 22:30 pas leximit të dytë, u miratua Ligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore, Ligji për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, Ligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, Ligji kundër dukurive negative në sport dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale.
24. Në vijim do të paraqitet një rrjedhë kronologjike e fakteve lidhur zhvillimin e të gjitha seancave të 5 dhjetorit 2024, duke përfshirë faktet lidhur me të gjitha projektligjet e shqyrtuara në parim në lexim të parë dhe në lexim të dytë dhe përcaktimin e detyrimit për Komisionet përkatëse për shqyrtimin e projektligjeve brenda një dite të vetme në Kuvend.

Përmbledhja e fakteve lidhur me seancën e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024 të mbajtur në orën 10:00

25. Më 25 nëntor 2024, Kryetari i Kuvendit përmes shkresës [L-VIII-SP-172/2] njoftoi deputetët e Kuvendit për vazhdimin e punimeve të seancës plenare të Kuvendit më 5 dhjetor 2024, ku në rend të ditës, ndër të tjera, përfshihej shqyrtimi në parim i (i) Projektligjit Nr. 08/L-315 për Banim Social dhe të Përballueshëm (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Banim Social dhe të Përballueshëm); (ii) Projektligjit Nr. 08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor); dhe (iii) Projektligji Nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (në tekstin e mëtejme: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim).
26. Më 5 dhjetor 2024, deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, përmes shkresave [08/6029/L-315], [08/6030/L-320] dhe [08/6034/L-21], mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, i propozuan Kryetarit të Kuvendit mocion procedural për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit lidhur me shqyrtimin e (i) Projektligjit për Banim Social dhe të Përballueshëm; (ii) Projektligjit

për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; dhe (iii) Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, duke i sugjeruar që, brenda ditës, Komisioni Funkcional përkatës dhe Komisionet e Përhershme, të paraqesin raportet me rekomandimet e tyre dhe që Projektligjet e lartcekura të shqyrtohen në seancat plenare të 5 dhjetorit 2024.

27. Në po të njëjtën ditë, Kuvendi në seancën e orës 10:00, pas procedurës së leximit të parë:

- (i) me 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm; dhe (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores Nr. 08-V-349 së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës e Kuvendit), të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
- (ii) me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; dhe (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit; dhe
- (i) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim; dhe (ii) me 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit.

28. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, pas miratimit në parim të Projektligjeve të lartcekura dhe parashtrimit të mocioneve procedurale të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! nxori vendimet e kontestuar si në vijim:

- përmes Vendimit [Nr. 08-V- 795] ngarkoi Komisionin Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm t'i adresohen Komisionit Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim deri në orën 13:20; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin e lartcekur dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë komisioneve të përhershme deri në orën 13:30; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim deri në orën 13:40; (iv) Komisioni Funkcional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm

për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orë 13:45; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 13:50;

- përmes Vendimit [Nr. 08–V- 796] ngarkoi Komisionin Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor t'i adresohen Komisionit Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale deri në orën 13:20; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin e lartcekur dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë komisioneve të përhershme deri në orën 13:30; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale deri në orën 13:40; (iv) Komisioni Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 13:45; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 13:50; dhe
- përmes Vendimit [Nr. 08–V-797] ngarkoi Komisionin Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim t'i adresohen Komisionit Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere deri në orën 13:55; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin e lartcekur dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 14:00; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere deri në orën 14:10; (iv) Komisioni Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 14:30; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 14:40.

29. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 5 dhjetor 2024:

- Komisioni Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i paraqiti Komisioneve të përhershme, përkatësisht (i) Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, (ii) Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, dhe (iii) Komisionit për Integrim Evropian, raportin e tij për miratimin e Projektligjit për Banim Social dhe të Përbalueshëm, duke i propozuar 10 (dhjetë) amendamente. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjin për Banim Social dhe të Përbalueshëm dhe amendamentet e propozuara dhe vlerësuan se i njëjti është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmban implikime buxhetore të përbalueshme, si dhe nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- Komisioni Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i paraqiti Komisioneve të përhershme raportin e tij për miratimin e Projektligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, duke i propozuar 2 (dy)

amendamente. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe amendamentet e propozuara dhe vlerësuan se i njëjti është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmban implikime buxhetore të përballueshme, si dhe nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian; dhe

- Komisioni Funkcional për Buxhet, Punë dhe Transfere i paraqiti Komisioneve të përhershme raportin e tij për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, pa amendamente. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe vlerësuan se i njëjti është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmban implikime buxhetore të përballueshme, si dhe nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
30. Të njëjtën ditë, raportet përfundimtare të Komisioneve Funktionale të lartcekura, së bashku me amendamentet e propozuara, iu shpërndanë të gjithë deputetëve të Kuvendit me rekomandimin që të miratohen Projektligji për Banim Social dhe të Përballueshëm, Projektligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Përmbledhja e fakteve lidhur me seancën e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024 të mbajtur në orën 14:40

31. Më 5 dhjetor 2024, Kuvendi në seancën plenare të orës 14:40, gjatë shqyrtimit të dytë miratoi (i) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Projektligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm dhe 10 (dhjetë) amendamentet e tij; (ii) me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe 2 (dy) amendamentet e tij; dhe (iii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, pa amendamente.
32. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, përmes:
- (i) Vendimit [Nr. 08-V-842] miratoi Ligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm;
 - (ii) Vendimit [Nr. 08-V-843] miratoi Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; dhe
 - (iii) Vendimit [Nr. 08-V-845] miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Përmbledhja e fakteve lidhur me seancën e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024 të mbajtur në orën 17:18

33. Gjykata fillimisht vë në pah se kjo seancë plenare e Kuvendit, sipas deklarimeve të Kuvendit, ishte caktuar të mbahej në orën 14:00 mirëpo e njëjta është mbajtur në orën 17:18.

34. Më 25 nëntor 2024, Kryetari i Kuvendit përmes shkresës [L-VIII-SP-176] njoftoi deputetët e Kuvendit për mbajtjen e seancës plenare të Kuvendit më 5 dhjetor 2024 në orën 14:00, ku në rend të ditës, ndër të tjera, përfshihej shqyrtimi në parim i (i) Projektligjit Nr. 08/L-300 për Provimin e Maturës Shtetërore (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore); (ii) Projektligjit Nr. 08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore); (iii) Projektligjit Nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.06/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore); (iv) Projektligjit Nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore); (v) Projektligjit Nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport (në tekstin e mëtejme: Projektligji kundër dukurive negative në sport); (vi) Projektligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Shërbimet e Pagesave); dhe (vii) Projektligjin Nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale (në tekstin e mëtejme: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale).
35. Më 5 dhjetor 2024, Deputetja Mimoza Kusari – Lila nga Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!, në emër të deputetëve nënshkrues, përmes shkresës [08/6057/10-652] i propozoi Kryetarit të Kuvendit plotësimin e rendit të ditës për seancën plenare të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, ashtu që të radhiten si pika të rendit të ditës: (i) shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejme: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit); (ii) shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare XXI Prishtina 2030 (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Lojërat Mesdhetare); (iii) shqyrtimi i dytë i Projektligjit Nr. 08/L-304 për Bankat (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Bankat); (iv) shqyrtimi i dytë i Projektligjit Nr. 07/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut); dhe (v) shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Shërbimet e Pagesave).
36. Në të njëjtën ditë, Kuvendi në seancën plenare të orës 17:18 (i) me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, përfshiu si pika të rendit të ditës shqyrtimin e parë të Projektligjit për Lojërat Mesdhetare, Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit si dhe shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Bankat dhe Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; ndërsa (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, përfshiu si pikë të rendit të ditës shqyrtimin e parë të Projektligjit për Shërbimet e Pagesave.

Përkritazi me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Bankat dhe Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut që rezultoi në vendimet e kontestuara të Kuvendit [Nr. 08-V-821] dhe [Nr. 08-V-822]

37. Nga shkresat e lëndës rezulton se Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut ishte miratuar në parim nga Kuvendi më 16 maj 2024 ndërkaq që Projektligji për Bankat ishte miratuar në parim nga Kuvendi më 11 korrik 2024. Rrjedhimisht, Gjykata

vëren se në seancën e orës 14:00 të 5 dhjetorit 2024, Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Projektligji për Bankat janë shqyrtuar në lexim të dytë, ndryshe nga Projektligjet e tjera të lartcekura që u shqyrtuan dhe u miratuan në parim. Në vijim, Gjykata do të paraqesë në mënyrë të përmbledhur faktet përkitazi me seancën e orës 17:18 të Kuvendit.

38. Më 5 dhjetor 2024 (i) raporti përfundimtar i Komisionit Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere, së bashku me 13 (trembëdhjetë) amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit me rekomandimin që Projektligji për Bankat me amendamente të miratohet në shqyrtim të dytë; dhe (ii) raporti përfundimtar i Komisionit Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, së bashku me 14 (katërmëdhjetë) amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit me rekomandimin që Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut me amendamente të miratohet në shqyrtim të dytë.
39. Në të njëjtën ditë, Kuvendi gjatë seancës plenare:
- (i) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi amendamentet e Projektligjit për Bankat dhe me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, miratoi Projektligjin për Bankat; dhe
 - (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.
40. Më tej, rezulton se më 5 dhjetor 2024, Kuvendi (i) përmes Vendimit [Nr. 08-V-821] miratoi Ligjin për Bankat; dhe përmes Vendimit [Nr. 08-V-822] miratoi Ligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Përkitazi me shqyrtimin në parim të Projektligjeve tjera në seancën e orës 17:18

41. Kuvendi, në seancën plenare të orës 17:18 të 5 dhjetorit 2024, pas procedurës së leximit të parë:
- (i) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Lojërat Mesdhetare dhe mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
 - (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
 - (iii) me 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Shërbimet e Pagesave; dhe (ii) me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit

Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;

- (iv) me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, 1 (një) kundër dhe 4 (katër) abstenime, e miratoi në parim Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore; dhe (ii) me 60 (gjashtëdhjetë) vota për, 1 (një) kundër dhe 1 (një) abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
- (v) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore; dhe (ii) me 60 (gjashtëdhjetë) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
- (vi) me 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; dhe (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
- (vii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; dhe (ii) me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit;
- (viii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi në parim Projektligjin kundër dukurive negative në sport; dhe me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, 1 (një) kundër dhe asnjë abstenim miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!; për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit; dhe
- (ix) me 60 (gjashtëdhjetë) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale; dhe me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim miratoi mocionin procedural të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores së Kuvendit, të mbështetur në nenin 65

[Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit.

42. Nga shkresat e lëndës, rezulton se, në po të njëjtën ditë, deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, përmes shkresave respektive, mbështetur në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, i propozuan Kryetarit të Kuvendit mocion procedural për shmangie nga afatet procedurale të përcaktuara me nenin 76 dhe paragrafin 1 të nenit 52 të Rregullores së Kuvendit lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjeve të lartcekura, të cilat ishin miratuar në parim në seancën e orës 17:18.
43. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, pas miratimit në parim të Projektligjeve të lartcekura dhe parashtrimit të mocioneve procedurale të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! nxori vendimet e kontestuar si në vijim:
- përmes Vendimit [Nr. 08 –V- 799] ngarkoi Komisionin Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Lojërat Mesdhetare, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin për Lojërat Mesdhetare t'i adresohen Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport deri në orën 19:00; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin e lartcekur dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë komisioneve të përhershme deri në orën 19:15; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional të lartcekur deri në orën 19:20; (iv) Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Lojërat Mesdhetare për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 19:25; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 19:30;
 - përmes Vendimit [Nr. 08–V- 800] ngarkoi Komisionin Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin në fjalë t'i adresohen Komisionit Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere deri në orën 19:10; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin e lartcekur dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë komisioneve të përhershme deri në orën 19:20; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 19:25; (iv) Komisioni Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin e lartcekur për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 19:30; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 19:35;
 - përmes Vendimit [Nr. 08–V- 801] ngarkoi Komisionin Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për shërbimet e pagesave, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin në fjalë t'i adresohen Komisionit Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere deri në orën 19:10; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin e lartcekur dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë komisioneve të përhershme deri në orën 19:20; (iii)

Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 19:25; (iv) Komisioni Funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin e lartcekur për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 19:30; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 19:35;

- përmes Vendimit [Nr. 08-V-802] ngarkoi Komisionin Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin e lartcekur t'i adresohen Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport deri në orën 19:15; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 19:20; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 19:25; (iv) Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 19:30; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore të bëhet në seancë plenare nga ora 19:35;
- përmes Vendimit [Nr. 08-V-803] ngarkoi Komisionin Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimin si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin e lartcekur t'i adresohen Komisionit Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim deri në orën 21:50; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin në fjalë dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 22:00; (iii) Komisionet e përhershme të shqyrtojnë Projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 22:10; (iv) Komisioni Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimin si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 22:20; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 22:30;
- përmes Vendimit [Nr. 08-V-804] ngarkoi Komisionin Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin e lartcekur t'i adresohen Komisionit Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim deri në orën 21:50; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin në fjalë dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 22:00; (iii) Komisionet e përhershme të shqyrtojnë Projektligjin për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 22:10; (iv) Komisioni Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore për shqyrtim të

dytë në seancë plenare deri në orën 22:20; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 22:30;

- përmes Vendimit [Nr. 08–V-805] ngarkoi Komisionin Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin e lartcekur t'i adresohen Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport deri në orën 22:10; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 22:15; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 22:20; (iv) Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 22:25; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 22:30;
- përmes Vendimit [Nr. 08–V-806] ngarkoi Komisionin Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin kundër dukurive negative në sport, ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin e lartcekur t'i adresohen Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport deri në orën 22:10; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin në fjalë dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 22:15; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin kundër dukurive negative në sport dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 22:20; (iv) Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin e lartcekur për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 22:25; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër dukurive negative në sport të bëhet në seancë plenare nga ora 22:30;
- përmes Vendimit [Nr. 08–V-807] ngarkoi Komisionin Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit si dhe Komisionet e përhershme që të shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale ashtu që brenda ditës (i) amendamentet për Projektligjin e lartcekur t'i adresohen Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport deri në orën 22:10; (ii) ky i fundit të shqyrtojë Projektligjin në fjalë dhe raportin me rekomandime t'ia paraqesë Komisioneve të përhershme deri në orën 22:15; (iii) Komisionet e përhershme, të shqyrtojnë Projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funksional përkatës deri në orën 22:20; (iv) Komisioni Funksional të paraqesë raportin me rekomandime për Projektligjin e përdryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale për shqyrtim të dytë në seancë plenare deri në orën 22:25; dhe (v) shqyrtimi i dytë i Projektligjit të bëhet në seancë plenare nga ora 22:30.

44. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 5 dhjetor 2024:

- Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport i paraqiti Komisioneve të përhershme raportin e tij për miratimin, me 1 (një) amendament të (i) Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore; dhe pa amendamente të (ii) Projektligjit për Lojërat Mesdhetare; (iii) Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; dhe (iv) Projektligjit kundër dukurive negative në sport. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjet si më lart dhe vlerësuan se të njëjtat janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmbajnë implikime buxhetore të përballueshme, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- Komisioni FunkSIONAL për Buxhet, Punë dhe Transfere i paraqiti Komisioneve të përhershme raportet e tij për miratimin pa amendamente të (i) Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; dhe (ii) Projektligjit për Shërbimet e Pagesave. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjet në fjalë dhe vlerësuan se të njëjtat janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmbajnë implikime buxhetore të përballueshme, si dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian; dhe
- Komisioni FunkSIONAL për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim i paraqiti Komisioneve të përhershme raportin e tij për miratimin pa amendamente të (i) Projektligjit për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimin si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; dhe (ii) Projektligjit për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjet në fjalë dhe vlerësuan se të njëjtat janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmbajnë implikime buxhetore të përballueshme, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian; dhe
- Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit i paraqiti Komisioneve të përhershme raportin e tij për miratimin pa amendamente të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale. Në të njëjtën ditë, Komisionet e përhershme shqyrtuan Projektligjin e lartcekur dhe vlerësuan se i njëjti është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e aplikueshëm, përmban implikime buxhetore të përballueshme, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

45. Të njëjtën ditë, raportet përfundimtare të Komisioneve FunkSIONALE, së bashku me amendamentet e propozuara, iu shpërndanë të gjithë deputetëve të Kuvendit me rekomandimin që Projektligjet e lartpërmendura të miratohen.

Përmbledhja e fakteve lidhur me seancën e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024 të mbajtur në orën 19:30

46. Më 5 dhjetor 2024, Kuvendi në seancën plenare të orës 19:30, gjatë shqyrtimit të dytë miratoi me 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim (i)

Projektligjin për Lojërat Mesdhetare dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; (ii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Projektligjin për Shërbimet e Pagesave; dhe (iii) me 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratoi Projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore; dhe me (iv) 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim amendamentin e tij të vetëm.

47. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, përmes:

- (i) Vendimit [Nr. 08-V-846] miratoi Ligjin për Lojërat Mesdhetare;
- (ii) Vendimit [Nr. 08-V-847] miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; dhe
- (iii) Vendimit [Nr. 08-V-848] miratoi Ligjin për Shërbimet e Pagesave; dhe
- (iv) Vendimit [Nr. 08-V-849] miratoi Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore.

Përmbledhja e fakteve lidhur me seancën e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024 të mbajtur në orën 20:10

48. Nga shkresat e lëndës rezulton se, në seancën e jashtëzakonshme të orës 20:10 të 5 dhjetorit 2024, Projektligji Nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative (në tekstin e mëtejme: Projektligji për Gjykatën Administrative) është shqyrtuar në lexim të dytë, ndërkaq që i njëjti ishte miratuar në parim nga Kuvendi më 14 prill 2024. Në këtë aspekt, rezulton se (i) më 21 nëntor 2024, raporti përfundimtar i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, së bashku me 17 (shtatëmbëdhjetë) amendamentet e propozuara iu shpërnda të gjithë deputetëve të Kuvendit me rekomandimin që Projektligji për Gjykatën Administrative me amendamente të miratohet në shqyrtim të dytë. Në vijim, Gjykata do të paraqesë në mënyrë të përmbledhur faktet përkitazi me seancën e jashtëzakonshme të orës 20:10 të Kuvendit.
49. Më 5 dhjetor 2024, Deputeti Adnan Rustemi nga Grupi parlamentar Lëvizja Vetëvendosje!, në emër të deputetëve nënshkrues, përmes shkresës [08-6058-DO6053] i propozoi Kryetarit të Kuvendit thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, përkatësisht më 5 dhjetor 2024 në orën 20:10, për shqyrtimin në lexim të dytë të Projektligjit për Gjykatën Administrative.
50. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Kuvendit përmes shkresës [L-VIII-SP-179] njoftoi deputetët e Kuvendit për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit në orën 20:10, për shqyrtim në lexim të dytë të Projektligjit për Gjykatën Administrative.
51. Më tej, rezulton se deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizje Vetëvendosje!, përmes shkresës [08-60598-L-291], mbështetur në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, i propozuan Kryetarit të Kuvendit mocion procedural për shmangie nga afatet procedurale të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 52 (Rendi i ditës për seancë plenare) të Rregullores së Kuvendit lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Gjykatën Administrative.
52. Në të njëjtën ditë, Kuvendi gjatë seancës së jashtëzakonshme të orës 20:10, me (i) 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratoi shmangien nga afatet procedurale; (ii) 63 (gjashtëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim,

miratoi amendamentet e Projektligjit për Gjykatën Administrative; dhe me (iii) 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi Projektligjin për Gjykatën Administrative.

53. Më tej, rezultoi se më 5 dhjetor 2024, Kuvendi përmes Vendimit [Nr. 08-V-850] miratoi Ligjin për Gjykatën Administrative.

Përmbledhja e fakteve lidhur me seancën e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024 të mbajtur në orën 22:30

54. Më 5 dhjetor 2024, Kuvendi në seancën plenare të orës 22:30, gjatë shqyrtimit të dytë miratoi me 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim (i) Projektligjin për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore; (ii) Projektligjin për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; (iii) Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; (iv) Projektligjin kundër dukurive negative në sport; dhe (v) Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale.

55. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, përmes:

- (i) Vendimit [Nr. 08-V-851] miratoi Ligjin për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore;
- (ii) Vendimit [Nr. 08-V-852] miratoi Ligjin për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- (iii) Vendimit [Nr. 08-V-853] miratoi Ligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore;
- (iv) Vendimit [Nr. 08-V-854] miratoi Ligjin kundër dukurive negative në sport; dhe
- (v) Vendimit [Nr. 08-V-855] miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesave

I. Pretendimet përkitazi me shkeljen e neneve 74 [Ushtrimi i Funksionit], 76 (Rregullorja e Punës) dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 53 dhe 123 të Rregullores së Kuvendit

56. Parashtruesit nëpërmjet kërkesave: KO246/24, KO247/24, KO249/24, KO250/24, KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24, dhe KO259/24, kontestojnë kushtetutshmërinë Vendimeve të para dhe të dyta të Kuvendit, të seancës së 5 dhjetorit 2024, me të cilat janë miratuar Ligjet përkatëse, si më poshtë:

- (i) Nëpërmjet kërkesës KO246/24, parashtruesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-801] dhe [Nr.08-V-848] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-328 për Shërbimet e Pagesave;
- (ii) Nëpërmjet kërkesës KO247/24, parashtruesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-806] dhe [Nr.08-V-854] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-326 kundër dukurive negative në sport;
- (iii) Nëpërmjet kërkesës KO249/24, parashtruesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-800] dhe [Nr.08-V-847] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.05/L-

- 096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- (iv) Nëpërmjet kërkesës KO250/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-802] dhe [Nr.08-V-849] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore;
 - (v) Nëpërmjet kërkesës KO252/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-795] dhe [Nr.08-v-842] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-315 për Banim social dhe të Përballueshëm;
 - (vi) Nëpërmjet kërkesës KO253/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-797] dhe [Nr.08-V-845] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;
 - (vii) Nëpërmjet kërkesës KO254/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-796] dhe [Nr.08-V-843], e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 - (viii) Nëpërmjet kërkesës KO255/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-807] dhe [Nr.08-V-855] e Kuvendi të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.08/L-168 për Prokurorinë Speciale;
 - (ix) Nëpërmjet kërkesës KO256/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-805] dhe [Nr.08-V-853] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore;
 - (x) Nëpërmjet kërkesës KO257/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-804] dhe [Nr.08-V-851], e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore;
 - (xi) Nëpërmjet kërkesës KO258/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-803] dhe [Nr.08-V-852] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
 - (xii) Nëpërmjet kërkesës KO259/24, parashtuesit e kërkesave kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-799] dhe [Nr.08-V-846] e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-334 për Lojërat Mesdhetare XXI Prishtina 2030;
57. Vendimet e lartcekura të Kuvendit, të nxjerra në seancën e 5 dhjetorit 2024, përmes të cilave janë miratuar Ligjet e lartcekura, përfshijnë procedurën pas miratimit të projektligjeve në parim (leximi i parë), dhe para miratimit të tyre në leximin e dytë.

i) Pretendimet për shkelje procedurale

58. Parashtuesit e kërkesave pretendojnë se mocioni procedural i gjashtë (6) deputeteve të shumicës parlamentare për “shmangie nga afatet procedurale” të përcaktuara me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, me të cilat është përcaktuar detyrimi që Komisioni Funkcional dhe Komisionet e Përhershme të shqyrtojnë Ligjet e kontestuar, në afatin kohor të dhënë në propozim për shmangie nga afatet procedurale është në kundërshtim të plotë me nenet 53 dhe 123 të Rregullores së Kuvendit.

59. Sipas parashtresve të kërkesave, referimi i mocionit procedural në nenin 123 të Rregullores së Kuvendit, me të cilën është propozuar shmangia nga afatet procedurale, bie në kundërshtim të plotë me përmbajtën e vet nenit 123 të kësaj rregulloreje.
60. Në këtë kontekst, parashtresit e kërkesave theksojnë se derisa Vendimet e kontestuara të Kuvendit i janë referuar nenit 123 të Rregullores, në të njëjtën kohë është caktuar mbajtja e seancës plenare, në orën e caktuar, e cila si çështje nuk hyn në “institutin” e shmangies nga afatet procedurale. Në këtë mënyrë parashtresit e kërkesave pretendojnë se, (i) është cenuar drejtpërdrejtë kompetenca kushtetuese e Kryetarit të Kuvendit, për të thirrur dhe caktuar seancat e Kuvendit, bazuar në nënparagrafin (2), paragrafin 7, të nenit 67 të Kushtetutës, si dhe (ii) përgjegjësitë e Kryesisë së Kuvendit që burojnë nga paragrafi 1, i nenit 19 të Rregullores së Kuvendit, që flet për miratimin e rendit të ditës të seancës plenare.
61. Për me tepër, parashtresit e kërkesave pretendojnë se Vendimet e kontestuara të Kuvendit, kanë cenuar edhe nenin 74 (Ushtrimi i Funkcionit) të Kushtetutës, për faktin se (iii) edhe deputeteve të Kuvendit u është pamundësuar ushtrimi i funksionit të tyre, a) për shkak të privimit nga e drejta për t’i shqyrtuar materialet e projektligjit/ligjit përkatës, për tu përgatitur për seancë, brenda një afati të arsyeshëm, së paku dyzetë e tetë (48) orë, para mbajtjes së seancës, dhe b) të drejtën për të propozuar amendamente për plotësim/ndryshimin e projektligjeve/ligjeve, siç përcaktohet me Rregulloren e Kuvendit.
62. Rrjedhimisht, parashtresit e kërkesave, pretendojnë se Vendimet e kontestuara të Kuvendit, i kanë privuar deputetet dhe komisionet përkatëse parlamentare nga e drejta për ushtrimin e funksioneve të tyre, për faktin se të njëjtit janë kufizuar në periudhën kohore prej 5-10 minutave që të bëjnë shqyrtimin e projektligjeve të kontestuara, për shkak të përcaktimit të:
- (i) afatit kohor prej pesë deri në dhjetë (5-10) minutave, për parashtrimin e amendamenteve në lidhje me projektligjin përkatës;
 - (ii) detyrimit që Komisioni Funkcional, të bëjë shqyrtimin e amendamenteve, dhe raportin me rekomandime t’ia paraqesë Komisioneve të Përhershme, në afat prej pesë deri dhjetë (5-10) minutave;
 - (iii) detyrimit që Komisionet e Përhershme ta shqyrtojë projektligjin përkatës dhe raportet me rekomandime t’ia paraqes Komisionit Funkcional, në afatin prej pesë deri dhjetë (5-10) minutave, dhe atë katër komisionet e përhershme në të njëjtën kohë;
 - (iv) detyrimin që Komisioni Funkcional, të paraqesë raportin me rekomandime në seancë plenare për shqyrtim në lexim të dytë, në afat prej pesë deri dhjetë (5-10) minutave; si dhe;
 - (v) detyrimin që Kuvendit të rishqyrtojë në lexim të dytë projektligjin përkatës në afat prej pesë deri dhjetë (5-10) minutave, pas përfundimit të punës së komisioneve parlamentare.
63. Në këtë drejtim, parashtresit e kërkesave pretendojnë se (i) “*deputeteve dhe (ii) komisioneve përkatëse të Kuvendit u janë cenuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre kushtetuese, duke e improvizuar një procedurë të tillë, e cila qartazi është joefektive dhe e cila në thelb përben cenim dhe degradim edhe të rolit kushtetues të Kuvendit, si institucioni*

me i lartë legjislativ në Republikën e Kosovës. Për më tepër, sipas parashtresve të kërkesave kjo shkelje argumentohet edhe përmes njoftimeve dhe ftesave të cilat deputetët i kanë pranuar nga Sekretaria e Kuvendit, përmes të cilave, ata janë ftuar dhe njoftuar, për seancën plenare, pas orës se paraparë për mbajtjen e së njëjtës.

ii) Pretendimet për shmangie nga afatet procedurale, sipas nenit 123 të Rregullores së Kuvendit

64. Në lidhje me këtë pretendim, parashtresit e kërkesave theksojnë se në dritën e interpretimit të nenit 123 të Rregullores së punës, Kuvendi nëpërmjet Vendimeve të kontestuara, (i) ka cenuar të drejtën e ushtrimit të pushtetit legjislativ, funksioni parësor i të cilit është procesi ligjvënës, duke iu referuar nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, i cili për rrjedhojë ka shkaktuar anashkalimin e të gjitha afateve procedurale të përcaktuara përmes së njëjtës rregullore, përfshirë afatet e parapara përmes procedurës së përshpejtuar të përcaktuar përmes nenit 85 të Rregullores së Kuvendit.
65. Në ndërlidhje me këtë, parashtresit e kërkesave konsiderojnë se referimi në nenin 123 të Rregullores së Kuvendit, është keqinterpretim i skajshëm i kësaj rregulloreje, kur dihet se shqyrtimi parlamentar i projektligjeve, në të cilin materializohet funksioni i deputetit dhe i Komisioneve Parlamentare, e cila përfshin procedurën ligjvënëse që u nënshtrohet afateve të parapara në nenin 74, 76 dhe 78 të Rregullores së Kuvendit, e ku shqyrtimi i një projektligji nga shpërndarja e materialeve, nga leximi i parë, e deri në leximin e dytë, mund të bëhet në afatin kohor prej së paku tridhjetë (30) ditëve.
66. Nga ana tjetër, parashtresit e kërkesave theksojnë se Rregullorja e Kuvendit, në nenin 85 dhe 86 të saj, ka përcaktuar përjashtimet nga rregulli i mësipërm, për faktin se në të njëjtën kohë paraqesin edhe kufijtë përfundimtar të periudhës kohore brenda së cilës mund të kufizohet një projektligj/ligj në të dyja leximet dhe atë në kushte të veçanta, të përcaktuara shprehimisht në këtë Rregullore. Në këtë kuptim, parashtresit e kërkesave, pretendojnë se, si Vendimet e para të Kuvendit, që i kanë paraprirë shmangies së afateve procedurale, po ashtu edhe Vendimet e dyta, të cilat janë rezultat i vendimeve të para, përveç se (i) nuk kanë përfillur afatet e përcaktuara përmes neneve 74, 76 dhe 78 të Rregullores së Kuvendit, për më tepër (ii) të njëjtat as nuk janë kufizuar në respektimin e afateve të përcaktuara përmes neneve 85 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit, të cilat paraqesin mundësinë e vetme të kufizimit maksimal të periudhës kohore, brenda së cilës mund të bëhet shqyrtimi dhe miratimi i një projektligji.
67. Tutje, parashtresit e kërkesave theksojnë se referimi i Vendimeve të kontestuara (vendimet e para) të Kuvendit, në nenin 123 të Rregullores së punës së Kuvendit, përben në të njëjtën kohë (i) shkelje jo vetëm të funksionit kushtetues të deputeteve dhe funksioneve parlamentare të tyre, por edhe (ii) shkelje të kufijve kohor të shqyrtimit parlamentar të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit. Në vijim, parashtresit e kërkesave theksojnë se neni 85 i Rregullores së Kuvendit, qartazi e përcakton procedurën e shqyrtimit të përshpejtuar të projektligjeve, duke vendosur afat kohor prej dyzet e tetë (48) orësh, për shqyrtimin në lexim të parë (pas shpërndarjes së materialeve), dhe afatin kohor prej shtatëdhjetë e dy (72) orësh, për shqyrtim në lexim të dytë, pas miratimit në parim të projektligjit përkatës. Ky fakt, sipas tyre, paraqet dëshmi se shmangia e përcaktuar përmes nenit 123 të Rregullores së Kuvendit nuk mund të anashkalojë apo të tejkalojë afatet eksplicite që e rregullojnë (i) çështjen e procedurës së përshpejtuar dhe/apo (ii) procedurën urgjente të projektligjeve. Rrjedhimisht, shmangia nga neni 123 i Rregullores së Kuvendit, me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të Ligjeve të lartcekura kontestuara, përben tejkalim

të përjashtimit të paraparë në këtë Rregullore dhe në të njëjtën kohë është në kundërshtim edhe me paragrafin 214 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastet KO216/22 dhe KO220/22.

68. Si rezultat, parashtuesit e kërkesave theksojnë se mungesa e rrethanave që do ta arsyetonte (i) procedurën e shqyrtimit të përshpejtuar nga neni 85 i Rregullores së Kuvendit (siguria kombëtare, shëndeti publik, çështjet buxhetore dhe financiare), si dhe mungesa e rrethanave që do ta arsyetonin (ii) procedurën e shqyrtimit urgjent nga neni 86 i Rregullores së Kuvendit (gjendja e jashtëzakonshme, gjendja emergjente), me të cilën janë miratuar Ligjet e lartcekura të Kuvendit, në pikëpamje kushtetuese, parlamentare dhe ligjore, e dërgojnë jashtë gamës së çështjeve për të cilat lejohet përjashtimi nga rregulli, e për rrjedhojë, kjo procedurë është kundërkushtetuese.
69. Prandaj, sipas tyre, Ligjet e kontestuar në aspektin e procedurës nuk mund të legjitimohen, duke iu referuar nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, ngase në të kundërtën, nëse do të lejohej tejkalimi i afateve procedurale edhe përkundër kufijve maksimal të shkurtimeve të tyre, në shqyrtimin parlamentar të ligjeve, atëherë do t'i humbte kuptimi dhe qëllimi, nenit 85 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit, dhe do t'i hapej rrugë krijimit të një praktikë abuzive parlamentare, ku shqyrtimi i ligjeve në të dyja leximet të mund të bëhet brenda një ore të vetme, pa pasur nevojë që të zbatohet procedura standarde e shqyrtimit parlamentar, e cila si e tillë, në esencën e saj është demokratike dhe e mëton transparencën dhe llogaridhënien.
70. Parashtuesit e kërkesave pretendojnë se Kuvendi nëpërmjet Vendimeve të para, që i kanë paraprirë nxjerrjes së Vendimeve të dyta, duke mos përfillur procedurën e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, (i) ka bërë shkelje të procedurës për miratimin e Ligjeve të kontestuar, duke cenuar paragrafin 1 të nenit 77 (Komisionet) të Kushtetutës, i cili parasheh llojet e komisioneve parlamentare, përfshi komisionet e përhershme të Kuvendit. Mbi bazën e nenit 77 (Komisionet) të Kushtetutës, theksojnë parashtuesit e kërkesave janë paraparë edhe kompetencat e komisionit në nenin 29 (Kompetencat e komisionit) të Rregullores së Kuvendit dhe në nenin 42 (Komisionet e përhershme dhe komisionet funksionale) të saj, ku në paragrafin 3 të këtij neni, janë paraparë katër (4) komisionet e përhershme të Kuvendit, ndërsa në paragrafin 5 të po të njëjtë neni, është paraparë përgjegjësia e këtyre komisioneve për shqyrtimin e të gjitha projektligjeve dhe akteve të tjera që miratohen në Kuvend. Këto nene shprehimisht përcaktojnë se Komisioni i Kuvendit, sipas fushëveprimit të tij, shqyrton projektligjet, aktet dhe dokumentet e tjera që parashtrihen për shqyrtim në Kuvend.
71. Përveç kësaj, parashtuesit e kërkesave, pretendojnë se Ligjet e kontestuar, në pikëpamje procedurale, bien ndesh edhe me nenin 76 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione), të Rregullores së Kuvendit, në të cilin shprehimisht është paraparë detyrimi që Komisionet e përhershme të shqyrtojnë projektligjin me amendamentet eventuale të propozuara. Ky nen, në paragrafin 8 shprehimisht përcakton: “8. Komisioni i përhershëm, shqyrton projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni përgjegjës-raportues, si dhe amendamentet e propozuara nga te autorizuarit sipas paragrafit 3 të këtij neni.” Komisioni i përhershëm, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e marrjes së raportit, duhet të paraqesë raportin për projektligjin dhe për amendamentet e Komisionit përgjegjës-raportues, ku pas këtij afati raporti i Komisionit përgjegjës raportues procedohet për miratim në seance plenare.

72. Si rezultat, parashtruesit e kërkesave konsiderojnë se Ligjet e kontestuara në procedurë janë miratuar në (i) shkelje esenciale të dispozitave të Rregullores së Kuvendit, duke cenuar kompetencat dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme parlamentare, dhe (ii) kompetencat e përcaktuara përmes nenit 77 [Komisionet] të Kushtetutës. Në mbështetje të këtyre pretendimeve parashtruesit e kërkesave i janë referuar praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, e cila sipas tyre në një situatë të tillë analoge, me rastin e ngritjes së kushtetutshmërisë së procedurës së shqyrtimit parlamentar të "*Projektligjit mbi Ngrohjen e Banesave*", me kërkesën e deputetit opozitar *Thomas Hellmann (CDU)*, kishte vendosur qartësisht se ligjet e propozuara nga Qeveria nuk mund të miratohen me nguti, sepse çdo deputet duhet të këtë kohë të mjaftueshme jo vetëm për të votuar për çështjen por për të marrë informacionin e duhur, për të studiuar projektligjin e propozuar (Shih Aktgjykimin e 5 korrikut 2023).
73. Për rrjedhojë, parashtruesit e kërkesave theksojnë se është më se e qartë se shmangia nga afatet procedurale përmes nenit 123 të Rregullores, paraqet keqpërdorim dhe keqinterpretim të "institutit" të shmangies, i cili ka quar në një procedurë të paligjshme, e cila i ka paraprirë nxjerrës së Ligjeve të kontestuara, duke i bërë ato edhe kundërkushtetuese dhe të kundërligjshme në pikëpamje procedurale. Andaj në dritën e fakteve të rastit, parashtruesit e kërkesave, kërkojnë nga Gjykata që të bëjë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, dhe të vlerësojë kushtetutshmërinë e Vendimeve të kontestuara, dhe të anulojë Ligjet e kontestuara, si të papajtueshëm me Kushtetutën në kuptimin procedural.

II. Pretendimet përkitazi me shkeljen e neneve 74 [Ushtrimi i Funkcionit] dhe 76 (Rregullorja e Punës) të Kushtetutës, në ndërlidhje nenet 52 dhe 123 të Rregullores së Kuvendit

74. Parashtruesit nëpërmjet kërkesave KO248/24, KO251/24, KO260/24, kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimeve të Kuvendit, të 5 dhjetorit 2024 në lidhje me procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të Ligjeve në lexim të dytë.
75. Më saktësisht parashtruesit e kërkesave:
- (i) përmes kërkesës KO248/24, kontestojnë Vendimin [Nr.08-V-850], e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, më të cilin është miratuar Ligji Nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative;
 - (ii) përmes kërkesës KO251/24 kontestojnë Vendimin [Nr.08-V-822], e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, më të cilit është miratuar Ligji Nr.07/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; dhe
 - (iii) përmes kërkesës KO260/24, kontestojnë Vendimin [Nr.08-V-821], e Kuvendit të 5 dhjetorit 2024, më të cilin është miratuar Ligji Nr.08/L-304 për Bankat.
76. Për dallim nga Ligji Nr.07/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, dhe Ligji Nr.08/L-304 për Bankat, Ligji Nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative është miratuar në procedurë (seancë) të jashtëzakonshme, të 5 dhjetorit 2024.

(i) Pretendimet për shkelje procedurale

77. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se mocioni procedural i gjashtë (6) deputeteve të shumicës parlamentare për “shmangie nga afatet procedurale” të përcaktuara përmes dispozitave të Rregullores së Kuvendit, ku përcaktohet detyrimi që shqyrtimi në lexim të dytë i projektligjeve të bëhet duke e përjashtuar detyrimin për njoftimin me kohe të deputeteve, për sa i perkat rendit të dietës dhe materialeve të seancës, siç përcaktohet me nenin 52 të Rregullores së Kuvendit, përben shkelje flagrante të dispozitave të kësaj rregulloreje, nga njëra anë, si dhe cenim të funksionit dhe mandatit të deputeteve sipas nenit 74 të Kushtetutës, nga ana tjetër.
78. Sipas, parashtruesve të kërkesave, referimi i mocionit procedural në nenin 123 të Rregullores së Kuvendit, me të cilën është propozuar shmangia nga afatet procedurale të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, është në shpërputhje me përmbajtjen e nenit 123 të kësaj rregulloreje. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesave e kontestojnë Vendimet [Nr.08-V-850], [Nr.08-V-822] dhe [Nr.08-V-821] të Kuvendit, me të cilët janë miratuar këto propozime, të cilit, në njërën anë kane vendosur për shqyrtim të dytë dhe të menjëhershëm të Ligjeve të miratuara me këto vendime, duke i privuar deputetet nga e drejta për t’u njoftuar me a) me ditën, b) kohen dhe c) materialet e ndërlidhura me shqyrtimin e dytë të ligjeve në fjalë.
79. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se Vendimet [Nr.08-V-850], [Nr.08-V-822] dhe [Nr.08-V-821] e Kuvendit, i janë referuar nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, i cili qartazi përcakton mënyrën dhe procedurën për “shmangie nga afatet procedurale”, e cila si e tillë, është qartazi në shpërputhje me përcaktimet nenin 52 të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit, është i detyrueshëm njoftimi i deputeteve me rendin e ditës dhe materialet e seancës, në afatin prej 48 orëve, para mbajtjes së seancës plenare përkatëse.
80. Për rrjedhojë, parashtruesit e kërkesave theksojnë se Vendimet e kontestuar [Nr.08-V-850], [Nr.08-V-822] dhe [Nr.08-V-821] të Kuvendit kanë: *“...cenuar edhe nenin 74 (Ushtrimi i Funksionit) të Kushtetutës, duke iu pamundësuar deputeteve si përfaqësues të popullit që të ushtrojnë funksionin e tyre “në interesin me të mirë të Republikës së Kosovës”, ngase të njëjtit janë privuar, në radhë të pare, nga e drejta për shqyrtimin e materialeve dhe përgatitjen për seancë brenda një afati të arsyeshëm (se paku brenda 48 orëve sa e përcakton rregullorja), dhe në radhë të dytë, janë privuar nga e drejta kushtetuese dhe ligjore për të parashtruar amendamente për ndryshimin dhe/apo plotësimin e ligjit të kontestuar.*

b) Pretendimet për shmangie nga afatet procedurale, sipas nenit 123 të Rregullores së Kuvendit

81. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesave në lidhje me shmangien nga afatet procedurale, sipas nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, Gjykata verën se të njëjtat janë identike me ato të cekura me sipër, andaj nuk e konsideron të nevojshme që t’i përsëris të njëjtat në lidhje me këto tri Vendime [Nr.08-V-850], [Nr.08-V-822] dhe [Nr.08-V-821] të Kuvendit, me të cilat janë miratuar tri Ligjet e lartcekura.

Komentet e dorëzuara nga Adnan Rustemi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!

82. Më 20 janar 2025, z. Adnan Rustemi, Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, (në tekstin e mëtejshëm: grupi

parlamentar i LVV-së) dorëzoi në Gjykatë komentet e tij ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave lidhur me vendimet e kontestuara të Kuvendit në kërkesat KO246/24, KO247/24, KO248/24, KO249/24, KO250/24, KO251/24, KO252/24, KO253/24, KO254/24, KO255/24, KO256/24, KO257/24, KO258/24, KO259/24 dhe KO260/24.

83. Grupi parlamentar i LVV-së pretendon se vendimet e kontestuara të Kuvendit janë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe se pretendimet e parashtruesve të kërkesave janë qartazi të pabazuara dhe nuk ngrenë çështje kontestuese.
84. Në këtë drejtim, përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për shkelje të nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës gjatë procedurës së miratimit të ligjeve të kontestuara, grupi parlamentar i LVV-së thekson se neni i lartcekur i Kushtetutës nuk rregullon procedurën kushtetuese të miratimit të ligjeve në komisione apo në seancë plenare. Sipas grupi parlamentar i LVV-së, neni 74 [Ushtrimi i Funksionit] i Kushtetutës parashih obligimin e deputetëve për përmbushjen e funksionit të tyre, duke respektuar rregullat kushtetuese, ligjore dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit, gjë të cilën, sipas tij, Kuvendi e ka respektuar gjatë procedurës që rezultoi në Vendimet e kontestuara, përmes të cilave u miratuan ligjet e shqyrtuara nga Kuvendi.
85. Në mbështetje të pretendimeve të tij, grupi parlamentar i LVV-së, duke iu referuar paragrafit 85 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin [KO45/18](#), thekson se termat që nuk janë të vendosur në Kushtetutë, nuk mund të jenë objekt kontrolli i kushtetutshmërisë para Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës [KO45/18](#), parashtrues *Glauk Konjufca dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 18 prillit 2018). Sipas Kryetarit të Komisionit për Legjislacion, neni 74 [Ushtrimi i Funksionit] i Kushtetutës nuk rregullon procedurën kushtetuese të miratimit të ligjeve në komisione apo në seancë plenare. Në këtë aspekt, i njëjti shton se neni 80 [Miratimi i Ligjeve] i Kushtetutës *“ka përcaktuar bazën kushtetuese të miratimit të ligjeve dhe hyrjes në fuqi të tyre, si dhe ka paraparë që Kuvendi rregullon funksionimin e brendshëm përmes Rregullores së Kuvendit, e cila miratohet me 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit”*, dhe se procedura e shqyrtimit nëpër komisione, leximet, shqyrtimet e miratimit të ligjeve dhe afatet e shqyrtimit në komisione e në seancë janë çështje që rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit.
86. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht Aktvendimit për papranueshmëri në rastin [KO115/13](#), në të cilin ishte konstatuar që vendimi i Kryesisë së Kuvendit dallon nga vendimi i Kuvendit për të cilin kërkohet shumica e deputetëve që janë të pranishëm dhe votojnë, grupi parlamentar i LVV-së thekson se paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës i cili autorizon Gjykatën që të vendosë lidhur me kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, nuk mund të zgjerohet në përfshirjen e akteve të brendshme të organeve të Kuvendit, vendimet e deputetëve individualë ose të zyrtarëve të Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës [KO115/13](#), parashtrues *Ardian Gjini dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri i 14 nëntorit 2013, paragrafi 50).
87. Tutje, grupi parlamentar i LVV-së shton se, përmes Aktgjykimit të Gjykatës në rastin [KO216/22 dhe KO220/22](#), ku ndër të tjera ishte kontestuar procedura e përshpejtuar e miratimit të ligjit, Gjykata kishte vlerësuar se mund të analizojë procedurën për miratimin e tij mbi bazën e dispozitave dhe parimeve relevante kushtetuese. Në ndërlidhje me këtë, grupi parlamentar i LVV-së pretendon se argumentet e parashtruesve të kërkesave lidhur me procedurën e ndjekur janë të pasakta pasi që Vendimet e kontestuara të Kuvendit janë në përputhje të plotë me nenet 53 (Ndryshimi i rendit të ditës) dhe 123 (Shmangia nga

afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit. Në këtë drejtim, duke iu referuar neneve të lartcekura të Rregullores së Punës së Kuvendit, grupi parlamentar i LVV-së thekson se, në përputhje me to dhe nga transkripti i seancave të 5 dhjetorit 2024, mocioni për shmangie nga afatet procedurale, i propozuar nga 6 (gjashtë) deputetë të Kuvendit është miratuar nga Kuvendi me 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm. Sipas grupit parlamentar i LVV-së, pretendimi i parashtruesve të kërkesave se shmangia nga afatet procedurale ka pamundësuar dhënien e kontributit nga Komisionet parlamentare dhe deputetët është i paqëndrueshëm pasi shmangia nga afatet procedurale (i) bazohet në Rregulloren e punës së Kuvendit; dhe e njëjta (ii) nuk përbën kufizim të të drejtave të deputetëve por paraqet shqyrtim më të shpejtë të projektligjeve, kur një mocion i tillë arsyetohet. Për më tepër, grupi parlamentar i LVV-së shton se pas miratimit të mocionit për shmangie nga afatet procedurale nga Kuvendi (i) Komisionet e përhershme duhet të shqyrtojnë Projektligjin dhe amendamentet përkatëse, në përputhje me afatet që ka caktuar Kuvendi me vendim; dhe se (ii) shmangia nga afatet procedurale nuk nënkupton heqjen e së drejtës së Komisioneve të përhershme apo të deputetëve për të ushtruar mandatin e tyre, por që afatet e shqyrtimit në mes të dy leximeve, afatet për shqyrtim nga Komisionet e përhershme, dhe për paraqitjen e amendamenteve duhet të bëhen në përputhje me afatet që ka përcaktuar vendimi Kuvendit.

88. Në lidhje me shmangien nga afatet procedurale të Rregullores së Punës së Kuvendit, në komentet e dorëzuara para Gjykatës, grupi parlamentar i LVV-së, duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin [KO57/12](#), në të cilin ishte kontestuar votimi për miratimin e Ligjit Nr. 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, thekson se Gjykata ka konstatuar se gjatë votimit/miratimit të Ligjit të lartcekur nuk është shkelur paragrafi 4 i nenit 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës [KO57/12](#), parashtrues *Presidentja e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 korrikut 2012, paragrafi 77).
89. Tutje, grupi parlamentar i LVV-së për Legjislacion thekson se, sipas paragrafit 2 të nenit 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, shmangia nga afatet procedurale mund të bëhet kur nuk bie ndesh me dispozitat e Kushtetutës. Në lidhje me këtë, i njëjti thekson se *“nuk ka shkelje të Kushtetutës kur Kuvendi shmang afatet procedurale dhe kërkon veprimin të përshpejtuar të trupave të Kuvendit siç janë komisionet parlamentare, përfshi edhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve siç përcaktohet në nenin 78 të Kushtetutës.”* Grupi parlamentar i LVV-së thekson se: *“[...] neni 67 paragrafi 7.2 i Kushtetutës dhe nenin 19 paragrafi 1 i Rregullores kanë përcaktuar mënyrën e caktimit të rendit të ditës, e jo të shqyrtimit të miratimit të ligjeve në kuptim të afateve.”* Gjithashtu, grupi parlamentar i LVV-së thekson se Projektligji nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme i është proceduar Kuvendit dhe shpërndarë deputetëve më 13 shtator 2024, duke shtuar se: *“[...] secili deputet dhe grup parlamentar që ka pasur interes ka pasur mundësi që përmes stafit profesional të Kuvendit por edhe stafit politik të përgatisë amendamente.”*
90. Grupi parlamentar i LVV-së shton se janë të paqëndrueshme pretendimet e parashtruesve të kërkesave lidhur me cenimin e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të Kryetarit të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit për caktimin e rendit të ditës dhe seancave plenare dhe shkeljen e nenit 74 [Ushtrimi i Funkcionit] pasi nënparagrafi 2 i paragrafit 7 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 19 (Detyrat e Kryesisë) të Rregullores së Punës së Kuvendit kanë përcaktuar mënyrën e caktimit të rendit të ditës, e jo të shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve në kuptim të afateve.

91. Sipas grupit parlamentar i LVV-së, përpjekja e parashtruesit të kërkesës për të kontestuar Vendimet e Kuvendit duke u bazuar në kohën që iu është lënë në dispozicion Komisioneve të përhershme dhe deputetëve, është përpjekje për të deformuar të vërtetën, pasi projektligjet i janë proceduar Kuvendit dhe shpërndarë deputetëve shumë kohë më parë dhe secili deputet dhe grup parlamentar ka pasur mundësi që të përgatitë amendamente.
92. Grupi parlamentar i LVV-së thekson se shqyrtimi dhe votimi i Vendimeve të kontestuara të Kuvendit është bërë në përputhje të plotë me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Sipas grupit parlamentar i LVV-së, përkitazi me shqyrtimin dhe miratimin e Vendimeve të kontestuara, Kuvendi, në përputhje me nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka shkurtuar afatet për secilën fazë të shqyrtimit, duke nisur nga afati për dorëzimin e amendamenteve, shqyrtimin e projektligjit dhe amendamenteve nga Komisioni përgjegjës-raportues, shqyrtimi i projektligjit dhe raportet me amendamente nga Komisionet e përhershme, paraqitja e raportit me rekomandime nga Komisioni përgjegjës –raportues dhe shqyrtimi i dytë i projektligjit në seancë plenare. Në lidhje me këtë, grupi parlamentar i LVV-së shton se *“nëse parashtruesit kanë konsideruar se është shkelur Rregullorja e punës së Kuvendit, parashtruesit kanë pasur të drejtën dhe mundësinë e referimit të çështjes brenda Kuvendit.”*
93. Në fund, grupi parlamentar i LVV-së thekson se pretendimet e parashtruesve të kërkesave, për shkelje procedurale kushtetuese, përveçse nuk përbëjnë çështje kushtetuese, të njëjtat janë plotësisht të pabazuara në raport me respektimin e procedurave të shqyrtimit të projektligjeve nëpër komisione dhe në seancë, brenda Kuvendit. Në këtë drejtim, i njëjti shton se ligjvënësi e ka organizuar punën e brendshme përmes miratimit të Rregullores së Punës, përmes të cilës ka përcaktuar funksionet e Komisioneve të përhershme dhe Funksionale dhe afatet për përmbushjen e tyre.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

I. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

- “1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*
- 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.*
- 4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.*
- 5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.*
- 6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*
- 7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.”*

Neni 7

[Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Neni 63

[Parimet e Përgjithshme]

“1. Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”

Neni 65

[Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

[...]”

Neni 67

[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve]

“1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.

[...]”

6. Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.

7. Kryetari i Kuvendit:

(1) përfaqëson Kuvendin;

(2) përcakton rendin e ditës, thërret dhe kryeson seancat;

(3) nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi;

(4) ushtron edhe funksione të tjera, në bazë të kësaj Kushtetute dhe Rregullore së Punës të Kuvendit.

[...]”

Neni 74

[Ushtrimi i Funksionit]

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Neni 76

[Rregullorja e Punës]

“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.”

Neni 77

[Komisionet]

“1. Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.

2. Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.
3. Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.
4. Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit.”

Neni 80 **[Miratimi i Ligjeve]**

- “1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.
3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.
4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.
5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.
6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.”

Neni 81* **[Legjislacioni me Interes Vital]**

1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:
 - (1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
 - (2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
 - (3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;
 - (4) ligjet për zgjedhjet lokale;
 - (5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;*
 - (6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
 - (7) ligjet për arsimin;
 - (8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.
 2. Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit
- Amendamenti 2:**
Neni 81 paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:
1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë.
- Amendamenti 3:**

Nenit 81 paragrafi 1. pika (5), fshihet dhe riformulohet si vijon:
(5) Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zonave të veçanta të mbrojtur

II. Dispozitat relevante të legjislacionit në fuqi

Rregullore Nr.08 -V- 349 e Kuvendit të Republikës së Kosovës **(e publikuar në Gazetën Zyrtare më 9 gusht 2022)**

Neni 19 **(Detyrat e Kryesisë)**

*“1. Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, diskuton për rendin e ditës të seancës plenare, të propozuar nga Kryetari i Kuvendit. Rendi i ditës miratohet me konsensus, dhe nëse nuk arrihet konsensusi, Kryetari ia paraqet rendin e ditës seancës plenare për miratim.
[...]”*

Neni 52 **(Rendi i ditës për seancë plenare)**

*“1. Kryetari i Kuvendit e përcakton rendin e ditës për seancën e radhës së Kuvendit, sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje. Rendi i ditës së bashku me materiale u shpërndahen deputetëve së paku dy (2) ditë pune, para mbajtjes së seancës plenare.
[...]”*

Neni 53 **(Ndryshimi i rendit të ditës)**

*“1. Rendi i ditës mund të ndryshohet në fillim të seancës plenare, në rastet kur:
1.1. Kryetari i grupit parlamentar, komisioni parlamentar ose së paku gjashtë (6) deputetë, propozojnë heqjen e një çështjeje nga rendi i ditës. Kuvendi vendos me votim për miratimin e atij propozimi.
1.2. Së paku gjashtë (6) deputetë, propozojnë më shkrim plotësimin e rendit të ditës. Për miratimin e këtij propozimi Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm.
1.3. Deputeti, duke e njoftuar paraprakisht Kryetarin e Kuvendit, propozon shqyrtimin e një çështjeje urgjente, sipas nenit 94 të kësaj rregulloreje.
2. Kryesuesi i seancës e hap diskutimin lidhur me propozimin, sipas nënparagrafëve 1.1. dhe 1.2, të këtij neni. Të drejtë diskutimi kanë, propozuesi dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Diskutimi mund të zgjasë deri në tre (3) minuta për secilin diskutues.”*

Neni 68 **(Seanca e jashtëzakonshme)**

*“1. Kryetari i Kuvendit, me kërkesën e Presidentit, Kryeministrit apo nga 1/3 e deputetëve thërret seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit.
2. Kërkesa për seancë të jashtëzakonshme, nga Presidenti apo nga Kryeministri duhet të përmbajë çështjen që do të shqyrtohet.
3. Kërkesa për seancë të jashtëzakonshme, nga 1/3 e deputetëve, duhet të përmbajë çështjen që do të shqyrtohet, nënshkrimet e deputetëve, të ndërlidhur me kërkesën për seancë të jashtëzakonshme. Deputeti mund ta tërheqë nënshkrimin deri në dorëzimin e kërkesës në Zyrën për propozime dhe parashtresa.
4. Seanca e jashtëzakonshme mbahet jo më vonë se 72 orë nga momenti i dorëzimit të kërkesës në Zyrën për propozime dhe parashtresa. Kohën e mbajtjes e përcakton thirrësi i seancës.
5. Në seancën e jashtëzakonshme diskutohet vetëm për çështjen e ngritur.”*

6. Deputeti mund të jetë pjesë e listës për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme, sipas paragrafit 3 të këtij neni, duke dërguar e-mail përmes postës elektronike zyrtare, me të cilin e konfirmon vullnetin e tij për thirrje të seancës. E-mail-i duhet ta përmbajë titullin e qartë, deklaratën e deputetit, çështjen, datën dhe kohën. E-mail-i i bashkëngjitet kërkesës për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme.”

KREU X PROCEDURA LIGJVËNËSE

Neni 70 (Propozimi i projektligjit)

- “1. Të drejtë për të propozuar projektligj në Kuvend ka:
- 1.1. Presidenti i Republikës së Kosovës, nga fushëveprimtaria e tij;
 - 1.2. Qeveria;
 - 1.3. Një deputet i përkrahur edhe nga së paku 5 deputetë;
 - 1.4. Së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Projektligji i propozuar, sipas nënparagrafëve 1, 3 dhe 4 të këtij neni, së bashku me shkresat e kërkuara në nenin 71 të kësaj rregulloreje, i dërgohet Qeverisë për mendim, përmes Kryetarit të Kuvendit. Qeveria paraqet mendimin e vet me shkrim, të nënshkruar nga Kryeministri, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të projektligjit. Pas kalimit të këtij afati, projektligji procedohet në Kuvend

Neni 71 (Kushtet për parashtrimin e një projektligji)

- “1. Projektligji, që procedohet në Kuvend përmban:
- 1.1. Shkresën shpjeguese për objektivat që synon t'i realizojë ligji, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe arsyetimin e dispozitave të ligjit;
 - 1.2. Deklaratën për ndikimin buxhetor në vitin e parë dhe dy vitet tjera në vijim;
 - 1.3. Deklaratën e përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, me tabelën krahasuese të akteve të cilave u referohet;
 - 1.4. Deklaratën për lekturim dhe për harmonizim gjuhësor.
2. Çdo projektligj që procedohet në Kuvend duhet të jetë në letër dhe në formë elektronike, i hartuar në gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze.
3. Zyra për propozime dhe parashtrësia, pas verifikimit të aspektit formal-juridik, e regjistron projektligjin sipas rendit të paraqitur dhe menjëherë ua shpërndan nga një kopje në letër çdo grupi parlamentar, dhe në mënyrë elektronike të gjithë deputetëve, së bashku me shkresën përcjellëse të nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit. Projektligji publikohet në faqen elektronike të Kuvendit.
4. Në rast se projektligji nuk i përmbush kushtet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, Kryetari ia kthen propozuesit projektligjin për plotësimet e nevojshme.”

KREU XI FAZAT E SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJIT

Neni 74 (Shqyrtimi i parë i projektligjit)

- “1. Shqyrtimi i parë i projektligjit në seancë plenare nuk mund të bëhet pa kaluar dy (2) javë nga dita e shpërndarjes së tij.
2. Para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare, Komisioni përgjegjës-raportues, i ngarkuar nga Kryetari i Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim.

Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit.

3. Shqyrtimi i parë i projektligjit përmban diskutimin dhe votimin e tij.

4. Diskutimi në parim për projektligjin zhvillohet pavarësisht rekomandimit të Komisionit përgjegjës-raportues.

5. Projektligji që nuk miratohet në shqyrtimin e parë në seancë plenare, nuk mund të paraqitet përsëri pa kaluar tre (3) muaj nga dita e mosmiratimit. Përfundim nga kjo rregull bëjnë projektligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.”

Neni 76

(Shqyrtimi i projektligjit në komisione)

“1. Pas miratimit në shqyrtim të parë, projektligji shqyrtohet nga komisioni përgjegjës-raportues.

2. Në rastin kur projektligji rregullon çështje nga fushëveprimi i dy (2) komisioneve funksionale, Kuvendi e ngarkon njërin prej tyre, si komision përgjegjës-raportues.

3. Amendament në projektligj mund të propozojë deputeti, komisioni parlamentar dhe Qeveria. Amendamentet i adresohen Komisionit përgjegjës-raportues, nëpërmjet Zyrës për propozime dhe parashtresa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita miratimit në parim.

4. Propozimi për amendamentin duhet të përmbajë: referimin ndaj dispozitës së projektligjit, formulimin e saktë të amendamentit dhe arsyetimin e amendamentit të propozuar.

5. Amendamenti i propozuar, i dërgohet Zyrës për propozime dhe parashtresa.

6. Në rast se amendamenti nuk i përmbushë kushtet sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, Zyra për propozime dhe parashtresa ia kthen propozuesit amendamentin, për plotësimet e nevojshme.

7. Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton projektligjin nen për nen dhe amendamentet e propozuara. Raporti me rekomandime u dërgohet komisioneve të përhershme.

8. Komisioni i përhershëm, shqyrton projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni përgjegjës-raportues, si dhe amendamentet e propozuara nga të autorizuarit sipas paragrafit 3 të këtij neni. Komisioni i përhershëm, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e marrjes së raportit, duhet të paraqesë raportin për projektligjin dhe për amendamentet e Komisionit përgjegjës-raportues, pas këtij afati raporti i Komisionit përgjegjës-raportues procedohet për miratim në seancë plenare.

9. Komisioni përgjegjës-raportues, pasi e përfundon shqyrtimin, i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime. Në raport përfshihen edhe mendimi i komisioneve të përhershme, si dhe deklarimi për amendamentet e propozuara nga deputeti, nga komisioni dhe nga Qeveria. Në raport shënohet edhe mendimi i anëtarëve që janë shprehur kundër.”

Neni 78

(Shqyrtimi i dytë i projektligjit)

“1. Shqyrtimi i dytë i projektligjit fillon me paraqitjen e raportit të komisionit përgjegjës-raportues. Pas paraqitjes së raportit, të drejtën e diskutimit, sipas radhës e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesi i grupit parlamentar, përfaqësuesi i Qeverisë, propozuesi i amendamenteve dhe deputeti.

2. Gjatë shqyrtimit të dytë në seancë plenare nuk mund të propozohen amendamente të reja, me përjashtim të rastit kur paraqitet nevoja për të evituar kolizionin e dispozitave të projektligjit. Me propozim të kryetarit të Komisionit përgjegjës-raportues, Kuvendi vendos për ndërprerjen e shqyrtimit të amendamenteve dhe e bart çështjen për shqyrtim

vetëm në Komisionin përgjegjës-raportues, i cili e paraqet raportin plotësues gjatë zhvillimit të seancës apo për seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i dytë i projektligjit vazhdon me shqyrtimin dhe me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni përgjegjës-raportues dhe të amendamenteve të propozuara nga komisionet e tjera nga Qeveria dhe nga deputetët. Para votimit të amendamentit mund të zhvillohet debat.

4. Radhitja e amendamenteve, të pasqyruara në tabelën krahasuese me dy kolona (teksti i projektligjit dhe i amendamenteve), për shqyrtim dhe për votim në seancë plenare bëhet sipas nenit 73 të kësaj rregulloreje.

5. Pas votimit të amendamenteve, votohet teksti i projektligjit me amendamentet e miratuara.

6. Me kërkesë të Komisionit përgjegjës-raportues votimi i projektligjit me amendamentet e miratuara mund të shtyhet në seancën e radhës.

7. Teksti i projektligjit me amendamentet e miratuara përgatitet nga njësia përkatëse organizative e Administratës së Kuvendit dhe i dërgohet Komisionit përgjegjës-raportues. Njësia gjatë përgatitjes së tekstit të projektligjit me amendamentet e miratuara kufizohet vetëm në eliminimin eventuale të mospërputhjeve terminologjike dhe ligjore në tekst ose të kolizioneve ndërmjet normave të projektligjit dhe normave të tjera të sistemit ligjor.

8. Komisioni përgjegjës-raportues, gjatë shqyrtimit të projektligjit me amendamentet e miratuara, nuk e shqyrton përmbajtjen e miratuar të projektligjit, por kufizohet vetëm sipas paragrafit 7 të këtij neni.

9. Komisioni përgjegjës-raportues tekstin e projektligjit, sipas paragrafit 8 të këtij neni, e procedon për miratim në Kuvend brenda pesë (5) ditë pune, nga dita e vendosjes sipas paragrafit 6 të këtij neni.

10. Në seancën e parë plenare pas dorëzimit të projektligjit me amendamentet eventuale, të propozuara në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni, procedohet me votimin përfundimtar të projektligjit.”

KREU XX TRANSPARENCA E KUVENDIT

Neni 85

(Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve)

“1. Shqyrtimi i parë i projektligjit me procedurë të përshpejtuar, nuk mund të bëhet më herët se 48 orë nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë nuk mund të bëhet më herët se 72 orë nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të gjendjes së jashtëzakonshme ose shpalljes së gjendjes emergjente.

2. Me kërkesë të Qeverisë ose të 1/4 të numrit të përgjithshëm të deputetëve, Kuvendi shqyrton me procedurë të përshpejtuar projektligjet që ndërlidhen me:

2.1. Sigurinë kombëtare;

2.2. Shëndetin publik; dhe

2.3. Çështje buxhetore dhe financiare.

3. Kërkesa nga paragrafi 2 i këtij neni i adresohet Kryetarit të Kuvendit, i cili e thërret seancën plenare.”

Neni 86

(Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit)

“1. Kuvendi, me kërkesë të Qeverisë ose 1/4 të të gjithë deputetëve të Kuvendit, mund të shqyrtojë projektligjin me procedurë urgjente, i cili ndërlidhet me marrjen e masave për gjendjen e jashtëzakonshme, sipas nenit 131 të Kushtetutës apo për gjendjen emergjente.

2. Shqyrtimi i projektligjit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, është i veçantë dhe shqyrtohet

vetëm nga Komisioni funksional, me përjashtim të rastit kur kërkohet sipas nenit 78, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i parë i projektligjit me procedurë urgjente bëhet brenda 48 orëve nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë bëhet brenda 72 orëve nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe.”

Neni 123

(Shmangia nga afatet procedurale)

“1. Me propozim të së paku gjashtë (6) deputetëve, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores.

2. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”

III. Dokumentet relevante në nivel të Këshillit të Evropës

- (i) Lista kontrolluese [[CDL-AD\(2016\)007](#)] e Komisionit të Venecias për Sundimin e Ligjit, miratuar më 11-12 Mars 2016;
- (ii) Parametrat [[CDL-AD\(2019\)015](#)] e Komisionit të Venecias lidhur me marrëdhënies në mes shumicës parlamentare dhe opozitës në një demokraci: një listë kontrolluese, miratuar më 21-22 qershor 2019;
- (iii) Përmbledhja [[CDL-PI\(2021\)003](#)] e Opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me procedurën e ligjbërjes dhe kualitetit të ligjeve, miratuar më 10-20 mars 2021;
- (iv) Raporti [CDL-AD \(2008\)035](#) mbi Iniciativën Legjislative të Komisionit të Venecias, i miratuar më 12-13 dhjetor 2008;
- (v) Raporti [CDL-AD\(2010\)025](#) mbi Rolin e Opozitës në një Parlament Demokratik, i miratuar më 15-16 tetor 2010;
- (vi) [Udhëzimet mbi Ligjbërjen Demokratike për ligje më të mira](#), OSBE/OHDIR, Poloni, 2023;
- (vii) Opinioni [[CDL-AD\(2013\)018](#)] i Komisionit të Venecias, për balancën e pushteteve në Kushtetutë dhe Legjislacionin e Principatës së Monakos, miratuar më 14-15 qershor 2013;
- (viii) Opinioni [[CDL-AD\(2017\)026](#)] i Komisionit të Venecias, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Kuvendit të *Verkhovna Rada të Ukrainës*, miratuar më 6-7 tetor 2017;
- (ix) Opinion i Përbashkët [[CDL-AD\(2020\)036](#)] , i OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias, për Shqipërinë lidhur me amendamentet e Kushtetutës, të 30 korrikut 2020 dhe të Kodit Zgjedhor të 5 tetorit 2020, miratuar më 11-12 dhjetor 2020;
- (x) Opinion [[CDL-AD\(2018\)021](#)] i Komisionit të Venecias lidhur me propozim-amendamentet të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale të Rumanisë, miratuar më 19-20 tetor 2018;

- (xi) Opinioni i ndërmjetëm urgjent [CDL-AD(2020)035], i Komisionit të Venecias, për draft-Kushtetutën e Bullgarisë, miratuar më 11-12 dhjetor 2020.

IV. Vendimet e Gjykatave Kushtetuese të vendeve tjera

- (i) Vendimi [K.2002/24](#) i Gjykatës Kushtetuese të Turqisë i 31 janarit 2002;
(ii) Vendimi [164/2011](#) i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë i 20 dhjetorit 2011;
(iii) Vendimi [PL. 13/2022-337](#) i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë i 13 dhjetorit 2022;
(iv) Vendimi [nr. 2BvE 4/23](#) i Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë i 5 korrikut 2023.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesave

94. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
95. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
96. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

97. Bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet të (i) të parashtrohet nga së paku 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit; (ii) të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, për përmbajtjen dhe/ose për procedurën e ndjekur; si dhe (iii) të parashtrohet brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.
98. Gjykata në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë, përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesat përkatëse, vëren se kërkesat janë parashtruar nga 12 (dymbëdhjetë) e më shumë deputetë, dhe rrjedhimisht kërkesat përmbushin kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje Gjykatën.
99. Gjykata gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, vëren se parashtruesit e kërkesave kontestojnë Vendimet e lartcekura të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit. Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohen kërkesat përkatëse në Gjykatë, vëren se kërkesat janë dorëzuar më 13 dhjetor 2024, që

nënkupton se të njëjtat janë dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

100. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesave legjitimohen si palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës për të kontestuar kushtetutshmërinë akteve të kontestuara para Gjykatës, si për nga përmbajtja, ashtu dhe për nga procedura e ndjekur, pasi në rastin konkret, që të gjithë janë deputetë të Kuvendit, andaj të njëjtit konsiderohen palë e autorizuar dhe rrjedhimisht, kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të miratuara nga Kuvendi.
101. Përveç kritereve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Neni 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”*

102. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“[...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

- (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendi i Republikës së Kosovës;*
 - (b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
 - (c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.*
 - (4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.*
- [...]”*

103. Në kontekst të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave (i) shënuan emrat dhe nënshkrimet në kërkesat e tyre; (ii) specifikuan aktet e kontestuara;

(iii) iu referuan neneve specifike të Kushtetutës, me të cilat pretendojnë se vendimet e kontestuara të Kuvendit nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) dorëzuan prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tij.

104. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave përkatëse, Gjykata deklaroi kërkesat e parashtruesve të kërkesave të pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e tyre.

Meritat e kërkesave

I. Hyrje

105. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesave, respektivisht dymbëdhjetë (12) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, kontestojnë (i) Vendimet e Kuvendit, përkitazi me miratimin e procedurës së shqyrtimit parlamentar në mes dy leximeve për 12 (dymbëdhjetë) Projektligjet si dhe miratimit të tyre si ligje, për të cilat pretendojnë se janë në kundërshtim me nenet 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës dhe se (ii) Vendimet e Kuvendit, përkitazi me procedurën e miratimit për shqyrtimin e dytë dhe miratimit të 3 (tre) ligjeve, përkatësisht Ligji për Gjykatën Administrative, Ligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Ligji për Bankat, për të cilat pretendojnë se të njëjtat janë në kundërshtim me nenet 74 [Ushtrimi i funksionit] dhe 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës.
106. Gjykata fillimisht rikujton se gjatë seancave të 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit janë miratuar (i) 12 (dymbëdhjetë) ligje të shqyrtuara në lexim të parë dhe të dytë brenda të njëjtës ditë; dhe (ii) 2 (dy) ligje, respektivisht Ligji për Bankat dhe Ligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, të cilat në seancën e 5 dhjetorit 2024 u shqyrtuan dhe miratuan vetëm në lexim të dytë; dhe (iii) 1 (një) ligj, përkatësisht Ligji për Gjykatën Administrative, i cili u miratua në lexim të dytë në seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit, të 5 dhjetorit 2024.
107. Parashtruesit e kërkesave pretendojnë se (i) Vendimet e Kuvendit, përkitazi me miratimin e procedurës së shqyrtimit parlamentar në mes dy leximeve për 12 (dymbëdhjetë) Projektligjet si dhe miratimit të tyre si ligje, janë në kundërshtim me nenet 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës dhe se (ii) Vendimet e Kuvendit, përkitazi me procedurën e miratimit për shqyrtimin e dytë dhe miratimit të 3 (tre) ligjeve, përkatësisht Ligji për Gjykatën Administrative, Ligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Ligji për Bankat, parashtruesit e kërkesave pretendojnë se të njëjtat janë në kundërshtim me nenet 74 [Ushtrimi i funksionit] dhe 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës.
108. Për më tepër, parashtruesit e kërkesave shtojnë se caktimi i seancës plenare përmes Vendimeve të lartcekura të Kuvendit cenon kompetencën kushtetuese të Kryetarit të Kuvendit për të thirrur seancat e Kuvendit sipas nënparagrafit 2 të paragrafit 7 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës dhe Kryesisë së Kuvendit, sipas paragrafit 1 të nenit 19 të Rregullores së Punës së Kuvendit.
109. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesave nuk kontestojnë të drejtën e deputetëve për thirrjen e seancave të jashtëzakonshme dhe mocionit për plotësim të rendit të ditës, mirëpo pretendojnë se procedura e ndjekur për miratimin e Projektligjeve ka rezultuar në shkelje

të nenit 74 [Ushtimi i funksionit] të Kushtetutës, me arsyetimin se (i) deputetëve iu është cenuar funksioni dhe mandati i tyre pasi janë privuar nga e drejta për shqyrtimin e materialeve dhe përgatitjen në kohë për seancë pasi nuk janë njoftuar 48 (katërdhjetë e tetë) orë më para, për rendin e ditës dhe materialet përkatëse, siç parashihet me paragrafin 1 të nenit 52 të Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe nga e drejta për votim lidhur me mocionin procedural për shmangie; dhe (ii) shmangia bazuar në nenin 123 të Rregullores së Punës së Kuvendit nuk është arsyetuar pasi nuk kanë ekzistuar rrethana nga nenet 85 dhe 86 të Rregullores së Punës së Kuvendit lidhur me procedurën e përshpejtuar/urgjente të miratimit të tyre.

110. Në anën tjetër, pretendimet e parashtruesve të kërkesave kundërgumentohen nga Kryetari i Komisionit për Legjislacion. Sipas Kryetarit të Komisionit për Legjislacion, pretendimet e parashtruesve të kërkesave për shkelje procedurale kushtetuese nuk përbëjnë çështje kushtetuese. Në këtë drejtim, Kryetari i Komisionit për Legjislacion thekson se neni 74 [Ushtimi i funksionit] i Kushtetutës nuk rregullon procedurën kushtetuese të miratimit të ligjeve në komisione apo në seancë plenare, por parasheh obligimin e deputetëve për përmbushjen e funksionit të tyre, duke respektuar rregullat kushtetuese, ligjore dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit, gjë të cilën, sipas tij, Kuvendi e ka respektuar gjatë procedurës që rezultoi në vendimet e kontestuara, përmes të cilave u miratuan ligjet e shqyrtuara nga Kuvendi.
111. Duke iu referuar Aktvendimit për papranueshmëri në rastin [KO115/13](#), Kryetari i Komisionit për Legjislacion thekson se paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës i cili autorizon Gjykatën që të vendosë lidhur me kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, nuk mund të zgjerohet në përfshirjen e akteve të brendshme të organeve të Kuvendit, vendimet e deputetëve individuale ose të zyrtarëve të Kuvendit.
112. Kryetari i Komisionit për Legjislacion pretendon se Vendimet e kontestuara të Kuvendit janë në përputhje të plotë me nenet 53 (Ndryshimi i rendit të ditës) dhe 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit, pasi shmangia nga afatet procedurale (i) bazohet në Rregulloren e Punës së Kuvendit; (ii) nuk përbën kufizim të të drejtave të deputetëve por paraqet shqyrtim më të shpejtë të projektligjeve, kur një mocion i tillë arsyetohet; (iii) Komisionet e përhershme duhet të shqyrtojnë Projektligjin dhe amendamentet përkatëse, në përputhje me afatet që ka caktuar Kuvendi me vendim; dhe se (iv) shmangia nga afatet procedurale nuk nënkupton heqjen e të drejtës së Komisioneve të përhershme apo të deputetëve për të ushtruar mandatin e tyre, por që afatet për shqyrtim dhe për paraqitjen e amendamenteve duhet të bëhen në përputhje me afatet që ka përcaktuar vendimi Kuvendit.
113. Më tej, Kryetari i Komisionit për Legjislacion shton se janë të paqëndrueshme pretendimet e parashtruesve të kërkesave lidhur me cenimin e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të Kryetarit të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit për caktimin e rendit të ditës dhe seancave plenare dhe shkeljen e nenit 74 [Ushtimi i funksionit], pasi nënparagrafi 2 i paragrafit 7 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 19 (Detyrat e Kryesisë) të Rregullores së Punës së Kuvendit kanë përcaktuar mënyrën e caktimit të rendit të ditës, e jo të shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve në kuptim të afateve.
114. Në vijim të kësaj, me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur që rezultoi në Vendimet e kontestuara të Kuvendit nga ana e parashtruesve të kërkesës, Gjykata në dritën e argumenteve dhe kundër-argumenteve të prezantuara, do të shtjellojë fillimisht (i) parimet e përgjithshme kushtetuese që ndërlidhen me ndarjen e pushtetit dhe

sundimin e ligjit, në kontekst të kompetencës së Kuvendit për miratimin e ligjeve dhe të drejtave dhe detyrimeve të deputetëve të Kuvendit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në procesin e ligjbërjes; (ii) parimet dhe standardet e specifikuar përmes opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias; (iii) praktikën gjyqësore të Gjykatave Kushtetuese të vendeve tjera; dhe në fund (iv) do të vlerësojë kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur nga Kuvendi më 5 dhjetor 2024, duke aplikuar përgjatë këtij vlerësimi parimet e përgjithshme të lartcekura.

II. Parimet e përgjithshme

1. Parimet e përgjithshme kushtetuese

115. Gjykata, fillimisht thekson që Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës. Normat e parapara me Kushtetutë duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën ngase vetëm në atë mënyrë nxirret kuptimi i saktë i tyre. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera (shih, ndër tjerash rastin KO173/22, parashtrues *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, Aktgjykim, i 8 nëntorit 2023, paragrafi 122).
116. Gjykata thekson se bazuar në nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit] të Kushtetutës, Republika e Kosovës është “*shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm*”. Në këtë kontekst, përkufizimi “demokratik” i shtetit të Kosovës, ndër të tjera dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, plotësohet përmes 4 (katër) neneve thelbësore kushtetuese, përkatësisht nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenit 7 [Vlerat] dhe nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (shih, rastet nr. KO100/22 dhe KO101/22, me parashtrues të kërkesës [KO100/22](#), *Abelard Tahiri dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*; me parashtrues të kërkesës [KO101/22](#), *Arben Gashi dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Aktgjykim i 24 marsit 2023, paragrafët 154-155).
117. Së pari, neni 3 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, ndër të tjera, saktëson që (i) Republika e Kosovës, qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore; dhe (ii) ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës, bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
118. Së dyti, neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, ndër të tjera, saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të

- njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
119. Së treti, neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, saktëson që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit shtetëror dhe barazisë gjinore.
 120. Gjykata thekson që parimi i sundimit të ligjit i përfshirë në nenin 3 dhe 7 të Kushtetutës, ndër të tjera, përfshin edhe parimin e sigurisë juridike.
 121. Në vijim, neni 16 [Epërsia e Kushtetutës] i Kushtetutës, përcakton që Kushtetuta është akti më i lartë i Republikës së Kosovës dhe se ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me të, se pushteti qeverisës buron nga Kushtetua, se Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare dhe se secili person dhe organ e institucion në Republikën e Kosovës i nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.
 122. Në kuptim të kompetencave të Kuvendit, që burojnë nga neni 4 i Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ, ndërsa bazuar nënin 63 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, *“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”*, i cili sipas nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, ndër të tjera, (i) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme; (ii) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit; dhe (iii) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.
 123. Gjykata ka theksuar që: *“[...] që secila degë e pushtetit shtetëror duhet të veprojë në pajtim me Kushtetutën, dhe përbrenda fushëveprimit kushtetues, duke garantuar kështu, parimin e ndarjes së pushteteve dhe vlerave demokratike të qeverisjes. Gjykata rithekson se Kuvendi, si organ ligjvënës dhe si shtyllë e ndarjes së pushtetit, ka mandat për nxjerrjen e ligjeve në fusha dhe për çështje që i konsideron të rëndësishme për t'u rregulluar me ligj.”* (shih, rastin e Gjykatës [KO43/19](#) lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, parashtrues *Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit*, Aktgjykim i 13 qershorit 2019, paragrafi 71).
 124. Kushtetuta ka përcaktuar demokracinë e Republikës së Kosovës si demokraci parlamentare, duke i dhënë Kuvendit funksion përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës (shih, ndër tjerash nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës). Në veçanti, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit janë deputetët e Kuvendit të zgjedhur në zgjedhje të lira dhe demokratike. Ushtrimi i sovranitetit përmes të zgjedhurve të popullit është modaliteti kryesor dhe më i përhapur për të shprehur atë se çfarë “buron nga populli” dhe për ta reflektuar atë në veprime dhe vendime konkrete përmes sistemit të demokracisë përfaqësuese. Përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, ndërsa deputetët si përfaqësues të popullit nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues (shih, ndër tjerash nenin 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës) (Shih rastin e Gjykatës, [KO124/25](#), parashtrues *Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së*

Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me të të marra në seancat paraprahe dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar “transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025”, Aktgjykim i 26 qershorit 2025, paragrafi 105).

125. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe nenit 74 [Ushtrimi i Funkcionit] të Kushtetutës, i cili përcakton që: *“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”*
126. Gjykata rikujton faktin që bazuar në Kushtetutë, përkatësisht në nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit], ligjbërja është një ndër funksionet më thelbësore të Kuvendit dhe ndër funksionet më esenciale të përfaqësuesve të popullit, përkatësisht deputetëve të Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës [KO216/22](#) dhe [KO220/22](#), parashtrues: për kërkesën KO216/22 - Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë, dhe për KO220/22 - Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 2 gushtit 2023, paragrafi 210).
127. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata rithekson që ushtrimi i pushtetit legjislativ është funksioni më thelbësor i Kuvendit, siç është përcaktuar në nenet 4 [Forma e qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Këtë funksion i njëjti, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, e ushtron sipas mënyrës së përcaktuar në nenet 79 [Nisma Legjislative] dhe 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, ndërsa deputetët ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, siç është saktësuar në nenin 74 [Ushtrimi i Funkcionit] të Kushtetutës.
128. Ndërkaq, në kuptim të rregullave që përcaktojnë organizmin dhe procesin e vendimmarrjes së Kuvendit, neni 76 [Rregullorja e punës] i Kushtetutës specifikon që: *“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.”*
129. Për më tepër, Kushtetuta u përcakton rol të veçantë Komisioneve të Kuvendit, me theks, në procesin e ligjbërjes. Më saktësisht dhe në këtë kontekst, e njëjta në nenin 77 [Komisionet] të saj, përcakton kategoritë e komisioneve, duke i klasifikuar në të përhershme, funksionale dhe *ad hoc*, duke vënë theks në rëndësinë e përbërjes së tyre, përfshirë rolin e komuniteteve që nuk janë shumicë dhe duke deleguar rolin dhe procedurat përkatëse në nivel të Rregullores së Kuvendit. Rol të veçantë, Kushtetuta i përcakton Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në nenin 78 të tij, duke përcaktuar, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, edhe mundësinë që: (i) me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, që çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve; dhe (ii) kohën në dispozicion prej dy javësh që Komisioni të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar nëse zgjedh (shih, rastin e Gjykatës [KO216/22](#) dhe [KO220/22](#), cituar më lart, paragrafi 204).
130. Gjykata, ka theksuar se parimi i sigurisë juridike, i cili është i mishëruar në konceptin e sundimit të ligjit, i garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, dhe në të gjitha nenet e

KEDNJ-së, ndër të tjera, përcakton që normat ligjore duhet të jenë të qarta dhe si të tilla duhet të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet juridike të mbeten të parashikueshme (shih, në mënyrë të ngjashme, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO216/22 dhe KO220/22, cituar më lart dhe paragrafi 237, si dhe Aktgjykimin në rastin KO55/23, parashtues Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 2 mars 2023, përmes shkresës nr. 8/3509/Do/1493/1, Aktgjykim, i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 224).

131. Gjykata konsideron që kompetenca parësore e Kuvendit të Republikës së Kosovës si pushtet legjislativ, e përcaktuar me nenet 4 dhe 63 të Kushtetutës duhet të jetë në shërbim të detyrimeve që burojnë nga neni 7, e që ndërlidhet me sigurinë juridike gjatë procesit të ligjbërjes, përfshirë këtu të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga nenet 74 dhe 76 të Kushtetutës e që ndërlidhet me të drejtat dhe detyrimet e deputetëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ligjbërës.
132. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se respektimi i rregullave procedurale gjatë ushtrimit të kompetencave ligjbërëse përbën jo vetëm një domosdoshmëri formale, por edhe një garanci përmbajtësore për funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës. Andaj, cenimi i parimit të sigurisë juridike rrezikon besimin e qytetarëve në procesin e ligjbërjes. Kjo për faktin se procedurat legjislative nuk janë krijuar vetëm për të orientuar veprimet e deputetëve, por edhe për të siguruar që procedura e miratimit të ligjeve të jetë transparente, e parashikueshme dhe në pajtim të plotë me balancimin e pushteteve dhe të drejtat dhe detyrimet e deputetëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre të garantuara me Kushtetutë.
133. Rrjedhimisht, Gjykata rithekson që vlerësimi i procedurës së ndjekur gjatë miratimit të vendimeve të kontestuara do t'i nënshtrohet shqyrtimit të parimeve dhe standardeve në kuptim të ndarjes së pushteteve dhe sigurisë juridike gjatë procedurës së ligjbërjes, të përcaktuara me nenet 4 dhe 7 në ndërlidhje me nenet 74 dhe 76 të Kushtetutës.

2. Parimet e përgjithshme sipas Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias dhe praktika gjyqësore e shteteve tjera

(i) Opinionet dhe Raportet e Komisionit të Venecias

134. Komisioni i Venecias ka theksuar se “*pavarësisht ndryshimeve në opinione, ekziston konsensus për elementet thelbësore të sundimit të ligjit (Rule of Law), si edhe për ato të Shtetit të së drejtës (Rechtsstaat dhe État de droit) të cilat nuk janë vetëm formale, por edhe përmbajtësore (materieller Rechtsstaatsbegriff).*” Këto elemente thelbësore sipas Komisionit të Venecias janë: (1) Ligjshmëria, duke përfshirë një proces transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik për miratimin e ligjeve; (2) Siguria juridike; (3) Ndalimi i arbitraritetit; (4) Qasja në drejtësi para gjykatave të pavarura dhe të paanshme, duke përfshirë kontrollin gjyqësor të akteve administrative; (5) Respektimi i të drejtave të njeriut; dhe (6) Barazia para ligjit (shih, Listën kontrolluese [CDL-AD\(2016\)007](#), të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, miratuar më 11-12 mars 2016, faqe 18). Komisioni i Venecias e mbështetë këtë në atë se Sundimi i Ligjit është i ndërlidhur me demokracinë sepse sipas tij promovon llogaridhënie dhe qasje në të drejtat të cilat kufizojnë pushtetin e shumicës.
135. Komisioni i Venecias, në parim ka nënvizuar disa parime gjithëpërfshirëse që ndërlidhen me procedurën e ligjbërjes, që përfshijnë (i) kompetencën e Parlamentit për ligjbërje, (ii)

autonominë për të rregulluar procedurën e ligjbërjes (iii) efektivitetin gjatë procesit të ligjbërjes, (iv) racionalitetin, (v) ndjekjen e interesit publik, dhe (vi) pjesëmarrjen e opozitës dhe publikut të përgjithshëm në debate (shih, Përmbledhjen [CDL-PI\(2021\)003](#) e Opinioneve dhe raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me procedurën e ligjbërjes dhe kualitetit të ligjeve, miratuar më 10-20 mars 2021, faqe 11-13).

136. Së pari, Komisioni i Venecias në opinionet e nxjerra, lidhur me prerogativën e ligjbërjes së Parlamentit ka specifikuar që “[...] *Demokracia dhe sundimi i ligjit kërkojnë, në parim, që i gjithë legjislativimi i rëndësishëm të miratohet nga legjislativi. [...] Më e rëndësishmja, megjithatë, është që legjislativi të ketë kompetencë dhe autoritet të pavarur për të ushtruar pushtetin ligjvënës. Legjislativi duhet të ketë të drejtën të diskutojë, ndryshojë dhe miratojë ose shfuqizojë propozimet për legjislativim, si dhe të drejtën për të iniciuar ligje të reja.*” (shih paragrafët 20 dhe 21 të Opinionit CDL-AD(2013)018 për balancin e pushteteve përkthyer me Kushtetutën dhe Legjislativimin e Principatës së Monakos, miratuar më 14-15 qershor 2013).

137. Së dyti, në kuptim të autonomisë së Kuvendit për të rregulluar procedurën e miratimit të ligjeve në Kuvend, Komisioni i Venecias specifikon që: *“Në shumicën e regjimeve moderne kushtetuese dhe demokratike, konsiderohet se prerogativë thelbësore e Kuvendit është autonomia e tij ligjbërëse dhe organizative.”* Në këtë kuptim, është Kuvendi që rregullon dhe miraton Rregulloren e punës pa ndërhyrje të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror (shih, Opinionin CDL-AD(2017)026, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Kuvendit të Verkhovna Rada të Ukrainës, miratuar më 6-7 tetor 2017, paragrafi 22). Në vijim të kësaj theksohet që *“legjislatura duhet të jetë e lirë për të organizuar mbledhjet e saja plenare, për të vendosur ritmin e vet dhe për të përcaktuar se sa kohë nevojitet për të hartuar, rishikuar ose ndryshuar legjislativimin e propozuar.”* (shih, Opinionin CDL-AD(2013)018 lidhur me balancin e pushteteve në Kushtetutë dhe Ligj të Principatës së Monakos, miratuar më 14-15 qershor 2013, paragrafi 20).

138. Së treti, në kuptim të efektivitetit të procesit të ligjbërjes, Komisioni i Venecias ka nënvizuar edhe të drejtat e anëtarëve të Parlamentit. Në lidhje me këtë është specifikuar që *“një ligj i kuvendit duhet të arrijë një pajtim të vështirë midis efektivitetit të procesit ligjbërës dhe mbrojtjes së të drejtave të parlamentarëve. Në fazën e diskutimit të nismave legjislative, rregullat duhet të nxisin një ecuri racionale të debateve parlamentare drejt një vendimi, duke lejuar ushtrimin e të drejtave të anëtarëve të kuvendit në fushën e nismës legjislative dhe të drejtën e ndryshimit.”* (shih, paragrafin 129 të Raportit [CDL-AD\(2008\)035](#) mbi Iniciativën Legjislative të Komisionit të Venecias, i miratuar më 12-13 dhjetor 2008).

139. Së katërti dhe në kuptim të racionalitetit, Komisioni i Venecias ka theksuar që ligjbërja nuk është vetëm një akt i vullnetit politik, por duhet që të paraqiten edhe arsyet lidhur me politikbërjen (shih, Opinionin e ndërmjetëm urgjent [CDL-AD\(2020\)035](#) për draft-Kushtetutën e Bullgarisë, miratuar më 11-12 dhjetor 2020, paragrafi 17).

140. Tutje, në kuptim të parimit që ndërlidhet me ndjekjen e interesit publik, Komisioni i Venecias ka theksuar se është *“përgjegjësia e ndarë në mes të shumicës dhe opozitës në raport me shoqërinë, ose parimi i solidaritetit, i cili duhet të tejkalojë ndarjet partiake. Si shumica parlamentare dhe opozita duhet që të veprojnë bazuar në të njëjtin angazhim të përbashkët dhe të përgjegjshëm ndaj interesit publik të qytetarëve, të cilët janë burimi legjitim i pushtetit demokratik. [...] Shumica parlamentare, pikërisht sepse është shumicë, duhet që në ushtrimin e pushtetit të saj të veprojë me vetëpërmbytje dhe me respekt ndaj opozitës, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente [...]”* (shih, Parametrat [CDL-](#)

[AD\(2019\)015](#) e Komisionit të Venecias lidhur me marrëdhënies në mes shumicës parlamentare dhe opozitës në një demokraci, një listë kontrolluese, miratuar më 21-22 qershor 2019, paragrafi 25).

141. Në fund, lidhur me pjesëmarrjen e opozitës dhe publikut të gjerë në debate, Komisioni i Venecias ka nënvizuar se (i) “*demokracia e udhëhequr nga sundimi i ligjit nuk është vetëm te respektimi formal i procedurës që lejon shumicën parlamentare që të udhëheqë, por është edhe shqyrtimi dhe këmbimi kuptimplotë i qëndrimeve në mes të shumicës dhe opozitës [...]*” (shih, Opinionin e Përbashkët [CDL-AD\(2020\)036](#) për Shqipërinë lidhur me amendamentet e Kushtetutës, të 30 korrikut 2020 dhe të Kodit Zgjedhor të 5 tetorit 2020, të OSBE/ODIHR, miratuar më 10 dhjetor 2020 dhe të Komisionit të Venecias, miratuar më 11-12 dhjetor 2020, paragrafi 34); dhe (ii) sundimi i ligjit kërkon që publiku i gjerë duhet që të ketë qasje në draftimin e legjislacionit dhe të ketë mundësi domethënëse për të dhënë input (shih, *Opinionin e ndërmjetëm urgjent për Bullgarinë*, cituar më lart, paragrafi 15).
142. Në dritën e rrethanave të kërkesave para Gjykatës e që ndërlidhen me kohëzgjatjen e shqyrtimit të ligjeve në Kuvend, Komisioni i Venecias në listën e saj kontrolluese lidhur me parametrat e marrëdhënies në mes të shumicës parlamentare dhe të opozitës në një demokraci kishte theksuar që (i) është e vështirë të përkufizohet në abstrakt se sa kohë nevojitet për të debatuar lidhur me një ligj në Kuvend. Ligji apo Rregullorja e punës mund të përcaktojnë rregulla themelore që parandalojnë miratimin e nxituar të ligjeve, të tilla si intervalet midis leximeve dhe diskutimeve në një komision (paragrafi 71); (ii) sa i përket legjislacionit të zakonshëm, nëse Kuvendi (dhe në veçanti opozita) ka kohë adekuate të diskutojë një ligj duhet që të përcaktohet nga organi që e propozon rendin e ditës së Kuvendit dhe të komisioneve të tij në dritën e të gjitha rrethanave relevante, dhe në veçanti të kompleksitetit dhe rëndësisë së ligjit (paragrafi 73); (iii) “*Ligjet që ndryshojnë rregullimet themelore institucionale – për shembull, përbërja dhe parimet e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese – kërkojnë më shumë kohë sesa legjislacioni i zakonshëm [...] Projektligjet komplekse dhe të diskutueshme në parim kërkojnë njoftim veçanërisht të gjatë paraprak, dhe duhet të paraprihen nga drafte fillestare, mbi të cilat zhvillohet një lloj konsultimi (në internet). Publiku duhet të ketë një mundësi domethënëse për të dhënë kontribut [...]. Ndarja e kohës shtesë për konsultimet publike rrit mundësinë e opozitës për të ndikuar në përmbajtjen e propozimeve legjislative nga Qeveria ose shumica parlamentare. Shumica parlamentare nuk duhet të manipulojë procedurën për të shmangur konsultime të tilla publike.*” paragrafi 74); (iv) “*Në të kundërt, për miratimin e legjislacionit më pak të rëndësishëm apo jo-kontrovers, mund të hartohen afate më të shkurtra dhe procedura më të thjeshta (për shembull, mos përfshirja e vlerësimit specifik të një komisioni përkatës). Megjithatë, raste të tilla duhet të përcaktohen qartë dhe të përcaktohen specifikisht në rregullore.*” (paragrafi 75); dhe (v) “*Rendi i ditës për sesionin e radhës duhet të publikohet dhe materiali mbështetës duhet të vihet në dispozicion paraprakisht për opozitën dhe publikun e gjerë për t'u përgatitur për debatet mbi një çështje/projektligj të caktuar [...].*” (shih, Parametrat [CDL-AD\(2019\)015](#) e Komisionit të Venecias lidhur me marrëdhënies në mes shumicës parlamentare dhe opozitës në një demokraci, cituar më lart, paragrafi 80).
143. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se më 23 janar 2008, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) miratoi Rezolutën 1601 (2008) mbi “*Udhëzimet procedurale për të drejtat dhe përgjegjësitë e opozitës në një parlament demokratik*”. Rezoluta thekson rolin e opozitës politike si “*komponent thelbësor të një demokracie që funksionon mirë*”, dhe në fakt mbështet një institucionalizim të caktuar të të drejtave të opozitës parlamentare, duke përcaktuar një numër udhëzimesh nga të cilat parlamentet e shteteve anëtare ftohen të

frymëzohen. (Shih, Raportin CDL-AD(2010)025 për Rolin e Opozitës në një Parlament Demokratik të miratuar nga Komisioni i Venecias, në Sesionin e tij të 84-të Plenare, Venedik, 15-16 tetor 2010, paragrafi 1).

144. Në këtë kontekst, brenda parlamentit vendimet merren nga shumica, dhe një sistem parlamentar i qeverisjes karakterizohet nga fakti se qeveria zakonisht (edhe pse jo gjithmonë) do të ketë mbështetjen e shumicës. Opozita zakonisht është në pakicë, dhe pakica si rregull i përgjithshëm nuk ka kompetencë për të miratuar vendime. Funkcioni i opozitës nuk është të qeverisë. Në vend të kësaj, opozita mund të ketë funksione të tjera. Se si mund të renditen më mirë këto është e diskutueshme, por midis tyre mund të jenë këto në vijim:

- *“Të ofrojnë alternativa politike;*
- *Të artikulojnë dhe promovojnë interesat e votuesve të tyre (zgjedhësve);*
- *Të ofrojnë alternativa ndaj vendimeve të propozuara nga qeveria dhe përfaqësuesit e shumicës;*
- *Të përmirësojnë procedurat e vendimmarrjes parlamentare duke siguruar debat, reflektim dhe kundërshtim;*
- *Të shqyrtojnë me kujdes propozimet legjislative dhe buxhetore të qeverisë;*
- *Të mbikëqyrin dhe monitorojnë qeverinë dhe administratën;*
- *Të rrisin stabilitetin, legjitimitetin, llogaridhënien dhe transparencën në proceset politike.”* (Shih, Raportin mbi Rolin e Opozitës në një Parlament Demokratik, të cituar më sipër, paragrafi 25).

145. Udhëzimet e OSBE/ODIHR-it mbi Ligjvënien Demokratike për Ligje më të Mira theksojnë se shumica e kushtetutave lejojnë procedura të përsheptuara ose të shpejta kur ndryshimet ligjore janë të vogla dhe të pakontestueshme ose jo komplekse, ose kur ekziston një nevojë urgjente për të miratuar ligje të caktuara shpejt. Ndryshimet e thjeshta dhe të drejtpërdrejta në legjislacion - p.sh., nëse një ligj thjesht po përshtatet me miratimin e një ligji tjetër - nuk do të kërkojnë gjithmonë diskutime, vlerësime ose konsultime të gjera mbi politikën. Vendet mund të kenë procedura të veçanta, ose parlamentet mund të pajtohen thjesht, me konsensus, që të miratojnë legjislacion të tillë duke ndjekur procedurë të përsheptuar. Cilado qofshin marrëveshjet, kur afatet kohore më të shkurtra dhe procedurat më të thjeshta përdoren për të miratuar legjislacion ose ndryshime të vogla dhe të pakontestueshme ose jo komplekse, këto raste duhet të përcaktohen qartë dhe të kufizohen në mënyrë të rreptë në rregullore (shih, [Udhëzimet mbi Ligjvënien Demokratike për Ligje më të Mira](#), OSBE/ODHIR, Poloni, 2023, paragrafi 234).

146. Kur ligjet duhet të miratohen urgjentisht për shkak të një nevoje të ngutshme shoqërore, korniza zakonisht parashikon afate kohore të shkurtuara për diskutim në, ose me qeverinë dhe në parlament, si në fazën e komisioneve ashtu edhe në seancën plenare. Kur ligjet përgatiten nga organet ose agjencitë qeveritare, kjo do të thotë pak ose aspak konsultim me palët e interesuara ose publikun e gjerë, duke filluar me fazat e krijimit të politikave dhe hartimit. Në nivel parlamentar, në mënyrë të ngjashme nuk do të ketë kohë për diskutime të thella mbi dispozitat individuale në komisione ose në seancën plenare, dhe as nuk do të jenë të mundura procedurat e duhura të konsultimit. Ligjet e miratuara në këtë mënyrë mund të ngrenë dyshime për cilësinë e tyre, pasi mungesa e konsultimit dhe shqyrtimit të duhur parlamentar mund të çojë në boshllëqe dhe mospërputhje në legjislacion që mund të adresohen vetëm gjatë procedurave të shqyrtimit pas miratimit, pasi të ketë kaluar momenti i urgjencës (shih, [Udhëzimet mbi Ligjvënien Demokratike për Ligj më të Mirë](#), të cituar më sipër, paragrafi 235).

147. Për këtë arsye, është e rëndësishme që këto procese të mos përdoren tepër dhe të mbeten përjashtime, duke pasur parasysh se ato mund të kenë ndikime negative në të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, si dhe në cilësinë e legjislacionit. Përderisa ligjvënja e përsheptuar ndonjëherë mund të jetë e nevojshme, procedura të tilla urgjente duhet të zbatohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe kurrë në baza rutine ose automatikisht. Ato duhet të kufizohen në raste të vërteta urgjente, kur rrethanat nuk lejojnë zhvillimin e zakonshëm të procedurave, si brenda qeverisë edhe veçanërisht para parlamentit. Në asnjë rrethanë nuk duhet të zbatohen procedura të përsheptuara thjesht për të arritur shpejt objektivat e politikave, ose për të anashkaluar rregullat mbi konsultimin publik ose vlerësimet e ndikimit, duke shmangur mekanizmat përkatës të verifikimit, konsultimit dhe mbikëqyrjes. Një keqpërdorim i tillë ndikon në cilësinë e legjislacionit, dobëson kontrollin e jashtëm mbi qeverinë dhe shpërfill parimin e ndarjes së pushteteve. Për më tepër, përdorimi i shpeshtë i procedurave të përsheptuara për miratimin e legjislacionit ndikon në sigurinë ligjore; edhe për ekspertët ligjorë, do të jetë e vështirë të kuptohet gjendja aktuale (shih, [Udhëzimet mbi Ligjvënien Demokratike për Ligj më të Mirë](#), të cituar më sipër, paragrafët 236-238).

(ii) Praktika gjyqësore e Gjykatave Kushtetuese të vendeve tjera

148. Gjykata në vijim, i referohet Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë e cila para saj kishte vlerësimin e kushtetutshmërisë së disa dispozitave të plotësim–ndryshimeve të Rregullores së punës së Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë. Së pari, amendamenti i bërë në rregullin 60 të Rregullores së punës, përcaktonte që: “*Gjatë debatit të projektligjeve dhe ligjeve të propozuara në Kuvend, fjalimet e bëra në emër të grupeve të partive politike, komisioneve parlamentare dhe qeverisë janë të kufizuara në njëzet minuta dhe fjalimet e mbajtura nga deputetët në 10 minuta.*” Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese e Turqisë kishte nënvizuar që para këtij ndryshimi, sa i përket pyetjeve dhe përgjigjeve nuk kishte pasur kufizime dhe në këtë kuptim vlerësoi që deputetët kanë përgjegjësinë që të sigurojnë që preferencat dhe zgjidhjet e tyre politike të respektohen përmes pjesëmarrjes së gjerë në parlament në demokracitë moderne. Kështu, u konstatua se sa i përket domosdoshmërisë për të reflektuar vullnetin e parlamentit, rëndësia e pyetjeve dhe përgjigjeve nuk mund të mohohet dhe kufizimi prej 10 minutave të pyetjeve dhe përgjigjeve i ndalon deputetët nga ushtrimi i të drejtës së tyre për të bërë pyetje. Si rezultat i këtij konstatimi, Gjykata Kushtetuese kishte anuluar dispozitën e lartcekur të propozuar të Rregullores së punës. Përderisa, lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e rregullit 81.1.b të Rregullores së punës përmes të cilit përcaktohej që “*nuk mund të bëhen pyetje lidhur me nene specifike*”, Gjykata Kushtetuese kishte anuluar edhe këtë dispozitë pasi konstatoi që ndalimi absolut për bërjen e pyetjeve për nene specifike do të pengonte deputetët nga ushtrimi i pushtetit të tyre të përcaktuar me nenin 87 të Kushtetutës, dhe nga kryerja e detyrave të tyre. Në vijim, Gjykata Kushtetuese e Turqisë lidhur me vlerësimin e rregullit të plotësuar 81.4 të Rregullores së punës, përmes të cilit përcaktohej që “*grupeve të partive parlamentare, Qeverisë dhe Komisionit ka pesë minuta për të mbajtur fjalimet e tyre.*” E njëjta kishte nënvizuar që bazuar në nenin 68 të Kushtetutës së Republikës së Turqisë, partitë politike janë elementë të domosdoshëm të jetës politike demokratike. Kështu, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kohëzgjatja prej pesë minutave nuk ishte e mjaftueshme në mënyrë që këto organe të merrnin pjesë në procesin legjislativ dhe të ushtronin detyrat e tyre në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht e anuloi këtë dispozitë si jokushtetuese (shih, vendimin [K.2002/24](#), të Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, të 31 janarit 2002, përmbledhja e vendimit e qasshme në Buletinin e vendimeve të gjykatave kushtetuese të Komisionit të Venecias, B2002-2, fq. 335).

149. Gjykata Kushtetuese e Hungarisë në vendimin e saj në lidhje me kushtetutshmërinë e procedurës së miratimit të “Ligjit C të vitit 2011 për të Drejtën e Lirisë së Ndërgjegjes dhe Fesë, dhe për Kishat, Fetë dhe Komunitetet Fetare” në Parlamentin hungarez, kishte konstatuar që propozimi i amendamenteve të rëndësishme pak para votës finale kishte cenuar garancitë ligjore të ushtrimit demokratik të pushtetit (shih, vendimin [164/2011](#), të Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë, të 20 dhjetor 2011, *përmbledhja e vendimit e qasshme në Buletinin e vendimeve të gjykatave kushtetuese të Komisionit të Venecias*, B2011-3, fq. 495).
150. Tutje, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë në vendimin e saj në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurës së miratimit të ligjit të kontestuar në procedurë të përshpejtuar, ka theksuar se debati parlamentar dhe kërkesa kushtetuese që ligjet të shprehin vullnetin e deputetëve janë të lidhura ngushtë. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë vlerësoi se kufizimi i debatit ndikon në formimin e vullnetit të deputetëve. Kësisoj sipas saj, mungesa e mundësisë për të paraqitur propozime në mënyrën e duhur ose defekte të tjera procedurale të ngjashme pengojnë ose kufizojnë debatin mbi ato propozime. Debati është një nga qëllimet e procedurës parlamentare. Prandaj, shkelja e Rregullores së punës mund të rezultojë në konsekuenca kushtetuese, nëse, për shembull, debati dhe mundësia, veçanërisht për deputetët e pakicës parlamentare, për të marrë një qëndrim publik dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre për një projektligj, do të kufizoheshin rëndë ose plotësisht, ose nëse do të kishte një numër mangësish në të gjithë procedurën e cila në fund do të kishte të njëjtin efekt. Sipas Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuesit, mandati i lirë i deputetit i jep atij pavarësinë nga urdhrat e personave fizikë apo juridikë, autoriteteve publike dhe partive politike. Nëse një deputet do të jetë në gjendje të vendosë sipas ndërgjegjes dhe bindjeve të tij, ai ose ajo duhet të jetë në gjendje të formojë mendimin e tij, të paktën në një masë minimale, për një çështje të rëndësishme, e cila në këtë rast, duke iu referuar vlerës së mbrojtur kushtetuese të qëndrueshmërisë afatgjatë, ishte qartësisht në rrezik. Përndryshe sipas Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, do të ekzistonte rreziku që deputeti të bëhet thjesht një aktor pasiv në proces, gjë që do të krijonte tensione me natyrën e mandatit të tij të lirë. Në fund, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë ligjin e kontestuar e shpalli antikushtetues vetëm për shkak të një shkeljeve të rënda të rregullave të procedurës për miratimin e ligjeve (shih, vendimin [PL. 13/2022-337](#), të Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, të 13 dhjetorit 2022, përmbledhja e vendimit e qasshme në Buletinin e vendimeve të gjykatave kushtetuese të Komisionit të Venecias, [2023/1](#)).
151. Në fund, Gjykata Kushtetuese i referohet Vendimit [2BvE 4/23] të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, të 5 korrikut 2023, ku Senati i Dytë i kësaj gjykate urdhëroi Parlamentin Federal Gjerman të mos procedojë me leximin e dytë dhe të tretë të draft-Ligjit të Qeverisë Federale për të ndryshuar Ligjin e energjisë të ndërtesave). Parashtruesi i kërkesës, një deputet i një grupi parlamentar kishte kontestuar që procedura legjislative kishte cenuar të drejtat e tij si anëtar i Parlamentit Federal. Në Vendimin e saj për miratimin e masës së përkohshme, Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë, bazuar në fjalinë e dytë të nenit 38.1 të Ligjit Themelor, theksoi se kërkesa e parashtruesit nuk është qartazi e pabazuar dhe konsideroi se duke marrë për bazë rrethanat e veçanta që përkufizojnë mënyrën se si ishin zhvilluar procedura legjislative në fjalë, është e nevojshme të shqyrtohet tërësisht nëse ushtrimi i autonomisë procedurale të shumicës parlamentare mori parasysh mjaftueshëm të drejtat pjesëmarrëse të garantuara me kushtetutë të parashtruesit në këtë rast (shih, Vendimin nr. [2BvE 4/23](#) të Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë, të 5 korrikut 2023).

III. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur nga Kuvendi, gjatë miratimit të Ligjeve në seancën e 5 dhjetorit 2024

152. Para vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura që kontestohen nga parashtruesit e kërkesave, Gjykata fillimisht potencon kompetencën kryesore kushtetuese të Kuvendit për ligjvënje në nivel vendi dhe në kuadër të ushtrimit të kësaj kompetence është rrjedhimisht i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që në ushtrim të kompetencës së tij, bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës për “miratim të ligjeve”, të rregullojë çështjet që hyjnë në fushëveprimin e Projektligjeve të miratuara përmes vendimeve të kontestuara nga parashtruesit e kërkesave. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se Kuvendi ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet sistemit të pagave për Republikën e Kosovës. Të vetmin kufizim që Kuvendi e ka në ligjvënje është që të respektojë procedurat e ligjbërjes dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty (shih në këtë drejtim, rastin e Gjykatës [KO158/23](#) parashtrues *Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të ardhurat Personale Vjetore, Aktgjykim, i 19 qershorit 2024, paragrafi 109).
153. Gjykata po ashtu rikujton që Rregullorja e Kuvendit e miratuar sipas autorizimeve dhe kërkesave të nenit 76 të Kushtetutës përbën mjet dhe mekanizëm procedural përmes së cilës bëhet zbatimi i dispozitave kushtetuese konkrete (shih, paragrafin 106 të Aktgjykimit në rastin [KO119/14](#). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se neni 76 [Rregullorja e Punës] i Kushtetutës e konsideron Rregulloren e Kuvendit, të miratuar nga 2/3 e votave të deputetëve si një akt me fuqi ligjore detyruese përmes së cilës rregullohet organizimi dhe funksionimi i Kuvendit. Për më tepër, kjo dispozitë kushtetuese obligon Kuvendin të veprojë brenda procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi në përputhje me rendin kushtetutës të Republikës së Kosovës (Shih rastin e Gjykatës, [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 148).
154. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do të aplikojë (i) parimet kushtetuese që burojnë nga nenet 4 dhe 7 e që ndërlidhen me parimin e ndarjes së pushteteve dhe të sundimit të ligjit, si një nga vlerat më themelore të demokracisë parlamentare që ushtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e që ndërlidhet me kompetencën e ligjbërjes, në kuptim të neneve 63 dhe 65 të Kushtetutës, dhe të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga nenet 74, 76 dhe 77 të Kushtetutës gjatë procedurës së miratimit të ligjeve, (ii) për të vazhduar me aplikimin e parimeve dhe parametrave të specifikuar përmes opinionëve dhe raporteve të Komisionit të Venecias dhe OSBE/OHDIR, përkitazi me procedurën e ligjbërjes.

(i) Vlerësimi i procedurës së miratimit të 12 (dymbëdhjetë) Projektligjeve në seancat e 5 dhjetorit 2024, në lexim të parë dhe të dytë

155. Gjykata rikujton se Kuvendi, në seancën 5 dhjetorit 2024, miratoi dymbëdhjetë (12) ligje, në lexim të parë dhe të dytë: (i) Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave; (ii) Ligjin Nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport; (iii) Ligjin Nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; (iv) Ligjin Nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore; (v) Ligjin Nr. 08/L-315 për Banim Social dhe të Përballueshëm; (vi) Ligjin Nr.08/L-321 për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (vii) Ligjin Nr. 08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; (viii) Ligjin Nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale; (ix) Ligjin Nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; (x) Ligjin Nr. 08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore; (xi) Ligjin Nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; dhe (xii) Ligjin Nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare.

156. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesave që ndërlidhen me procedurën parlamentare, nga leximi i parë projektligjeve, deri në miratimin tyre si ligje, përmes leximit të dytë, Gjykata në vazhdim i referohet dispozitave të Rregullores së Kuvendit.

A. Procedura e miratimit të Ligjeve sipas Rregullores së Kuvendit

i) Procedura e rregullt e shqyrtimit dhe procedura e përshpejtuar dhe ajo urgjente e miratimit të projektligjeve në Kuvend

157. Në kuadër të leximit të dispozitave të Rregullores së Kuvendit që ndërlidhen me fazën e shqyrtimit të projektligjeve, Gjykata i referohet neneve 74, 76 dhe 78 të Rregullores së Kuvendit.
158. Neni 74 i Rregullores së Punës së Kuvendit parashikon se shqyrtimi i parë i projektligjit në seancë plenare nuk mund të mbahet pa kaluar 2 (dy) javë nga data e shpërndarjes së tij tek deputetët. Përpara këtij shqyrtimi, Komisioni përgjegjës–raportues, i caktuar nga Kryetari i Kuvendit, duhet të shqyrtojë projektligjin në parim dhe të përgatisë një raport me rekomandime për miratim ose mosmiratim. Pavarësisht rekomandimit të komisionit, Kuvendi zhvillon diskutim dhe votim në parim. Projektligji që nuk miratohet në shqyrtimin e parë nuk mund të paraqitet sërish para tre muajsh nga data e mosmiratimit, përveç në rastet që lidhen me marrëveshjet ndërkombëtare. Pas miratimit në parim, projektligji i kthehet Komisionit përgjegjës-raportues për shqyrtim nen për nen dhe për shqyrtimin e amendamenteve të propozuara.
159. Sipas nenit 76 të Rregullores së Punës së Kuvendit, afati për paraqitjen e amendamenteve nga deputetët, komisionet apo Qeveria është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e miratimit në parim. Amendamentet i paraqiten Komisionit përgjegjës nëpërmjet Zyrës për propozime dhe parashtrës, dhe nëse nuk përmbushin kriteret formale, mund t'u kthehen propozuesve për plotësime. Komisioni përgjegjës harton raportin përfundimtar me rekomandime dhe e dërgon atë në komisionet e përhershme, të cilat kanë po ashtu 15 ditë për të paraqitur mendimin e tyre. Pas përfundimit të kësaj faze, raporti procedohet për shqyrtim në seancë plenare.
160. Neni 78 i Rregullores së Punës së Kuvendit përcakton se shqyrtimi i dytë fillon me paraqitjen e raportit të Komisionit përgjegjës-raportues. Gjatë kësaj seance, të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, të grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët. Në këtë fazë nuk mund të propozohen amendamente të reja, përveç nëse ka nevojë për evitimin e kolizionit ndërmjet dispozitave të projektligjit. Në këto raste, shqyrtimi mund të ndërpritet dhe të kthehet në komision për trajtim të mëtejshëm. Pas përfundimit të shqyrtimit dhe votimit të amendamenteve të propozuara, votohet teksti i plotë i projektligjit me amendamentet e miratuara. Nëse Komisioni përgjegjës kërkon shtyrjen e votimit të projektligjit, kjo bëhet për seancën e radhës.

Administrata e Kuvendit përgatit tekstin e harmonizuar të projektligjit dhe komisioni përgjegjës e procedon atë për miratim brenda pesë (5) ditëve pune nga vendimi për shtyrje. Votimi përfundimtar zhvillohet në seancën e parë plenare pas dorëzimit të këtij teksti.

161. Gjykata rikujton se nenet 85 (Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve) dhe 86 (Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit janë të përcaktuara drejtpërdrejt në Kreun XI (Faza e shqyrtimit të projektligjit) të saj. Gjykata vëren se këto dispozita parashikojnë përjashtim nga rrjedha e rregullt procedurale gjatë shqyrtimit të projektligjeve të përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.
162. Në këtë drejtim, neni 85 i Rregullores së Kuvendit rregullon procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjeve, ndërsa neni 86 i Rregullores së Kuvendit rregullon procedurën urgjente të shqyrtimit të projektligjeve.
163. Gjykata vëren se nenet 85 (Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve) dhe 86 (Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit, rregullojnë (i) procedurën e përshpejtuar dhe (ii) urgjente të shqyrtimit të projektligjeve, procedurë e cila paraqet përjashtim nga rrjedha e rregullt procedurale gjatë shqyrtimit të projektligjeve të përcaktuar me dispozitat e lartcekura të Rregullores së Punës së Kuvendit.
164. Në këtë drejtim, paragrafi 1 i nenit 85 (Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve) i Rregullores së Punës së Kuvendit specifikon se shqyrtimi i parë i projektligjit me procedurë të përshpejtuar, nuk mund të bëhet më herët se 48 (katërdhjetë e tetë) orë nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë nuk mund të bëhet më herët se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të gjendjes së jashtëzakonshme ose shpalljes së gjendjes emergjente. Më tej, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se procedura e përshpejtuar e shqyrtimit zbatohet për projektligjet që ndërlidhen me (i) sigurinë kombëtare, (ii) shëndetin publik dhe (iii) çështjet buxhetore dhe financiare.
165. Në anën tjetër, neni 86 (Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit) i Rregullores së Punës së Kuvendit parasheh që, Kuvendi, me kërkesë të Qeverisë ose një të katërtën (1/4) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, mund të shqyrtojë projektligjin me procedurë urgjente, i cili ndërlidhet me marrjen e masave për (i) gjendjen e jashtëzakonshme, sipas nenit 131 të Kushtetutës apo për (ii) gjendjen emergjente, ku shqyrtimi i parë i projektligjit me procedurë urgjente bëhet brenda 48 (katërdhjetë e tetë) orëve nga shpërndarja e materialit, ndërsa shqyrtimi i dytë bëhet brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga dita e miratimit në parim, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe.
166. Gjykata vëren se nenet 85 (Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve) dhe 86 (Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit) të Rregullores së Punës së Kuvendit kërkojnë: (i) ekzistencën e rrethanave të përcaktuara, përkatësisht që procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të zbatohet për projektligjet që ndërlidhen me a) sigurinë kombëtare, b) shëndetin publik dhe c) çështjet buxhetore dhe financiare apo d) të ekzistojë gjendje emergjente/jashtëzakonshme; (ii) një kërkesë të formalizuar nga Qeveria ose një e katërta (1/4) e deputetëve, dhe (iii) respektimin e afateve minimale të përcaktuara për shpërndarjen e materialeve dhe zhvillimin e shqyrtimit në seancë plenare. Përkitazi me 12 (dymbëdhjetë) projektligjet e shqyrtuara në parim dhe në lexim të dytë në seancat e 5 dhjetorit 2024, Gjykata vëren që (i) 1 (një) nga 12 (dymbëdhjetë) ligjet e shqyrtuara nga Kuvendi, përkatësisht Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ndërlidhet me shëndetin publik, për të cilin sipas paragrafit 2 të nenit 85 (Procedura e

përsheptuar e shqyrtimit të projektligjeve) të Rregullores së Punës së Kuvendit lejohet procedura e përsheptuar e shqyrtimit të tyre.

167. Megjithatë, Gjykata vëren se, më 5 dhjetor 2024, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, shqyrtimi dhe miratimi i 12 (dymbëdhjetë) ligjeve të lartcekura nuk është zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara me nenet 85 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit.
168. Në vijim, Gjykata vë në dukje se ligjet e miratuara nga Kuvendi më 5 dhjetor 2024 ndërlidhen me çështje si sport, kulturë, treg, arsim, drejtësi, shëndetësi, banim, financa dhe mjedis dhe rrjedhimisht, të njëjtat nuk ndërlidhen ekskluzivisht me çështje të sigurisë kombëtare, shëndetit publik, apo çështje të buxhetit dhe financave, gjendjes së jashtëzakonshme në të cilat vetë Kuvendi, përmes rregullores së tij, përjashtimisht ka përcaktuar “*procedurë të përsheptuar*” apo/dhe “*procedurë urgjente*” të ligjërbjes.

ii) Shmangia nga afatet procedurale sipas nenit 123 të Rregullores së Kuvendit

169. Në fund, Rregullorja e Kuvendit në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të saj përcakton që me propozim të së paku 6 (gjashtë) deputetëve, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm për shmangie nga afatet procedurale të Rregullores. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Një dispozitë e ngjashme ka qenë e përcaktuar edhe në rregulloren paraprake të Kuvendit, të miratuar në vitin 2010, me dallimin se shmangia ka qenë e aplikueshme për rregulloren në tërësi dhe jo vetëm përkritazi me afatet procedural të saj.

B. Pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe kundërgargumentet e palëve të interesuara

170. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave para Gjykatës pretendojnë se (i) Vendimet e kontestuara të Kuvendit përmes të cilave është miratuar procedura e shqyrtimit parlamentar të 12 (dymbëdhjetë) Projektligjeve në mes shqyrtimit të parë dhe shqyrtimit të dytë, si dhe (ii) Vendimet e Kuvendit përmes të cilave janë miratuar po të njëjtat Ligje, janë në kundërshtim me nenet 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës.
171. Në anën tjetër, Kryetari i Komisionit për Legjislacion pretendon se vendimet e kontestuara të Kuvendit janë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe se pretendimet e parashtruesve të kërkesave janë qartazi të pabazuara dhe nuk ngrenë çështje kontestuese. Kryetari i Komisionit për Legjislacion tutje thekson se Vendimet e kontestuara të Kuvendit janë në përputhje të plotë me nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Punës së Kuvendit me arsyetimin se shmangia nga afatet procedurale bazohet në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe nuk paraqet kufizim të të drejtave të deputetëve por shqyrtim më të shpejtë të projektligjeve.

C. Vlerësimi i Gjykatës

172. Gjykata fillimisht thekson se sundimi i ligjit, si një ndër vlerat themelore të demokracisë dhe i garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, duhet të respektohet edhe në ushtrimin e pushtetit legjislativ. Ky pushtet përbën një nga funksionet kryesore të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe buron nga parimi i ndarjes së pushteteve, i përcaktuar me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], në lidhje me nenet 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Ashtu siç është theksuar

më lart, Kuvendi i Republikës së Kosovës, funksionin e tij ligjbërës e ushtron sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 79 [Nisma Legjislative] dhe nenin 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, ndërsa deputetët ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, siç është saktësuar në nenet 74 [Ushtrimi i Funksionit] 76 [Rregullorja e Punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës. Thënë këtë, Gjykata nënvizon se procedura e miratimit të ligjeve në Kuvend duhet të garantojë proces transparent, të përgjegjshëm dhe demokratik dhe kjo procedurë duhet të jetë gjithmonë në funksion të sigurisë juridike si një nga parimet parësore të sundimit të ligjit.

173. Përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, ndërsa deputetët si përfaqësues të popullit nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues (shih, ndër tjerash nenin 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës). Thënë këtë, neni 74 [Ushtrimi i Funksionit] i Kushtetutës, përfaqëson një garanci themelore për integritetin e funksionit përfaqësues të deputetëve, duke i lidhur ata drejtpërdrejt me rregullat kushtetuese, ligjore dhe procedurale të Kuvendit. Për më tepër, deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit të cilët kanë të drejta të barabarta si dhe obligim që të marrin pjesë plotësisht në procedurat e Kuvendit dhe që të kryejnë detyrat në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës KO09/11, parashtrues *Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011, Aktgjykim i 28 marsit 2011, paragrafi 80). Thënë këtë, Gjykata në vazhdimësi ka theksuar që deputetët kanë për obligim të marrin pjesë në punimet e Kuvendit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në votim përkitazi me propozimet e paraqitura në bazë të Kushtetutës dhe të rregullave tjera të ndërlidhura (shih, ndër tjerash rastin e Gjykatës [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 141).
174. Ky përcaktim, i zhvilluar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe që lidhet me detyrimin e deputetëve për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit, fillimisht është artikuluar në kontekste të tilla si zgjedhja e Presidentit dhe konstituimi i Kuvendit. Megjithatë, ky obligim nuk kufizohet vetëm në këto raste. Ai duhet të kontekstualizohet më gjerë, në funksion të garantimit të ushtrimit efektiv të pushtetit legjislativ dhe të respektimit të procedurave të ligjbërjes të përcaktuara me Kushtetutë dhe rregullat e Kuvendit. Në këtë kuptim, detyrimi për pjesëmarrje përfshin edhe praninë dhe votimin e deputetëve gjatë procesit të miratimit të ligjeve, si dhe respektimin e afateve dhe rregullave procedurale, duke shmangur çdo veprim që do të cenonte integritetin dhe funksionimin e rregullt të procesit legjislativ.
175. Sa i përket nenit 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës, Gjykata vëren se Rregullat e Kuvendit miratohen nga dy të tretat (2/3) e votave të deputeteve dhe me këtë nen përcaktohet se me të rregullohet organizimi i brendshëm dhe puna e Kuvendit.
176. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesave pretendojnë se me aplikimin e mocioneve procedurale për shmangie të afateve procedurale, sipas nenit 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit, përkitazi me procedurën e miratimit të 12 (dymbëdhjetë) projektligjeve, është shkelur Rregullorja e Kuvendit.
177. Më tej, neni 77 [Komisionet] i Kushtetutës përcakton kategoritë e komisioneve, duke i klasifikuar në të (i) përhershme, (ii) funksionale dhe (iii) *ad hoc*, duke vënë theks në rëndësinë e përbërjes së tyre, përfshirë rolin e komuniteteve që nuk janë shumicë, dhe duke

deleguar rolin dhe procedurat përkatëse në nivel të Rregullores së Kuvendit. Në këtë drejtim, paragrafi 2 i nenit 74 (Shqyrtimi i parë i projektligjit) të Rregullores përcakton që pas miratimit në shqyrtim të parë, projektligji shqyrtohet nga komisioni përgjegjës-raportues dhe se amendamentet në projektligj mund t'i propozojë deputeti, komisioni parlamentar dhe Qeveria. Sipas paragrafit 7 të nenit 76 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione) të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni i përhershëm, shqyrton projektligjin me amendamentet e propozuara dhe brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga data e marrjes së raportit, duhet të paraqesë raportin për projektligjin dhe për amendamentet e Komisionit përgjegjës-raportues, pas këtij afati raporti i Komisionit përgjegjës-raportues procedohet për miratim në seancë plenare.

178. Bazuar në parimet e lartëcekura, Gjykata do të vlerësojë (i) nëse miratimi i 12 (dymbëdhjetë) Ligjeve në lexim të parë dhe të dytë është zhvilluar në pajtim me garancitë kushtetuese që burojnë nga nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, në kuptim të respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të parimit të sundimit të ligjit gjatë procesit të ligjbërjes, (ii) nenit 74 të Kushtetutës në kontekst të ushtrimit të funksionit të deputetit dhe (iii) neneve 76 dhe 77 të Kushtetutës, në kuptim të respektimit të rregullave kushtetuese dhe procedurale gjatë procedurës së ligjbërjes.
179. Duke u mbështetur në nenin 123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit, Gjykata vëren se është zhvilluar procedura e cila ka rezultuar në Vendimet e kontestuara të Kuvendit përmes të cilave është lejuar shmangia nga afatet procedurale, e cila ka rezultuar në miratimin e 12 (dymbëdhjetë) Ligjeve, që ishin votuar në parim në seancën e Kuvendit, më 5 dhjetor 2024. Në të njëjtën ditë, para procedurës së leximit të dytë, Kuvendi, duke u bazuar në këtë nen të Rregullores së Kuvendit, kishte vendosur të shmangej nga afatet procedurale të kësaj rregulloreje, dhe gjatë seancave plenare të 5 dhjetorit 2024, të njëjtat ishin miratuar edhe në procedurën e leximit të dytë. Gjykata bazuar në përmbajtjen e dispozitave të nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, vëren se këtij të fundit i lejohet shmangia nga afatet procedurale të Rregullores, me kushtin që kjo shmangie të mos bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, shkronjën dhe frymën e saj.
180. Gjykata, rikujton se, përmes këtyre vendimeve, respektivisht vënies në lëvizje të nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, komisioneve të përhershme iu është alokuar një periudhë kohore prej 5 (pesë) - 10 (dhjetë) minuta për shqyrtim dhe adresim të amendamenteve, ku më konkretisht, në tërësi, periudha kohore nga adresimi i amendamenteve tek komisionet funksionale përkatëse, shqyrtimi i raportit me rekomandime nga ky i fundit dhe paraqitja e raportit të komisionet e përhershme, dhënien e rekomandimeve nga komisionet e përhershme dhe paraqitjen e raportit me rekomandime të komisioneve funksionale dhe shqyrtimin e dytë në seancë plenare, përfshin gjithsej 20 (njëzetë), deri në 45 (katër dhjetë e pesë) minuta.
181. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës të dorëzuara nga Kuvendi, po ashtu rezulton që, përmes Vendimeve të kontestuara të Kuvendit, për disa projektligje është caktuar orari i njëjtë për shqyrtim brenda komisioneve përkatëse.
182. Andaj, në dritën e elaborimit të më sipër Gjykata do të vlerësojë nëse miratimi i 12 (dymbëdhjetë) Ligjeve, përmes procedurës së shmangies së afateve, të cilat në fushëveprimin e tyre rregullojnë çështje që ndërlidhen me drejtësinë, ekonominë, financat, mjedisin, kulturën dhe sportin, ka respektuar përcaktimet dhe parimet kushtetuese dhe atyre ndërkombëtare të ligjbërjes si në kuptim të kompetencës thelbësore të Kuvendit si

organ ligjbërjes dhe të sundimit të ligjit, ashtu edhe në kuptim të të drejtave dhe detyrimeve të deputetëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ligjbërës dhe rregullave procedurale që burojnë nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit. Rrjedhimisht, Gjykata do të analizoje dhe vlerësojë nëse procedura e miratimit të këtyre ligjeve, brenda një dite përmes votimit të mocionit për shmangie nga afatet e rregullta procedurale është racionale në raport (i) me parimin e ligjshmërisë që buron nga Kushtetuta dhe rregullat përkatëse të ligjbërjes në Kuvend, (ii) të drejtat dhe detyrimet e deputetëve gjatë procedurave të shqyrtimit dhe përfshirjes së tyre në proces të ligjbërjes, si në aspekt të kontributit të tyre në amendementimin e projektligjeve të propozuar ashtu edhe në pjesëmarrjen e tyre në debate; dhe (iii) ushtrimit të funksionit thelbësor të Kuvendit si organ ligjbërës dhe të deputetëve të Kuvendit në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës.

183. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, vëren se më 5 dhjetor 2024 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mekanizmat e përcaktuar në nenin 85 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit nuk janë aktivizuar dhe nuk ka pasur kërkesa të Qeverisë apo një të katërtës (1/4) së deputetëve. Madje, në rrethanat e rastit, Gjykata ve në pah faktin se nuk ka pasur rrethana përjashtuese të cilat do e mundësonin aktivizimin e këtyre mekanizmave, përkatësisht nuk ka pasur gjendje të jashtëzakonshme ose shpallje të gjendjes emergjente, siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 85 (Procedura e përsheptuar e shqyrtimit të projektligjeve) të Rregullores së Punës së Kuvendit, apo nenin 86 (Procedura urgjente për shqyrtimin e projektligjit) të po të njëjtës rregullore, përkitazi me shqyrtimin urgjent të projektligjeve. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se procedurat e përcaktuara në nenet 85 (Procedura e përsheptuar e shqyrtimit të projektligjeve) dhe 86 (Procedura urgjente për shqyrtimin e projektligjit) të Rregullores së Kuvendit, nuk janë aplikuar në rrethanat e rastit konkret.
184. Gjykata, duke iu rikthyer rrethanave të rasti, rikujton që në orën 10:00 u miratua në parim në lexim të parë (i) Projektligji për Banim Social dhe të Përbalueshëm, (ii) Projektligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe (iii) Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Të njëjtat projektligje, në të njëjtën ditë, në orën 14:40 u miratuan pas leximit të dytë.
185. Më pas, në orën 17:18 u shqyrtuan dhe miratuan në parim (iv) Projektligji për Lojërat Mesdhetare, (v) Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, (vi) Projektligji për Shërbimet e Pagesave, (vii) Projektligji për Provimin e Maturës Shtetërore, (viii) Projektligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore, (ix) Projektligji për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, (x) Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, (xi) Projektligji kundër dukurive negative në sport dhe (xii) Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale. Në të njëjtën ditë, në seancën e Kuvendit të orës 19:30, orës 20:10 dhe 22: 30, pas leximit të dytë, u miratuan të gjitha projektligjet e cekura si në këtë paragraf.
186. Po ashtu, Gjykata vëren se pas miratimit në parim të 12 (dymbëdhjetë) Projektligjeve të shqyrtuara në seancën e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, ky i fundit në të njëjtën ditë ka shpërndarë tek deputetët e Kuvendit rendin e ditës dhe materialet për seancat plenare lidhur me shqyrtimin e dytë të tyre, të caktuar brenda ditës. Për më tepër, nga ftesat e përcjella nga Kuvendi, tek deputetët, përmes e-mailit, Gjykata vëren se të njëjtat ishin dërguar pas kohës në të cilën ishte paraparë fillimi i seancave ose pak minuta para se të njëjtat të fillonin. Më konkretisht, nga shkresat e lëndës rezulton se ftesat për seanca dhe

materialet përkatëse u janë shpërndarë deputetëve përmes e-mailit, pas kohës në të cilën ishte paraparë fillimi i seancave ose pak minuta para se të njëjtat të fillonin.

187. Për më tepër, në rastet e parashtruara pranë Gjykatës, të cilat kjo e fundit i ka bashkuar, respektivisht kërkesat: (i) KO246/24, (ii) KO247/24, (iii) KO248/24, (iv) KO249/24, (v) KO250/24, (vi) KO251/24, (vii) KO252/24, (viii) KO253/24, (ix) KO254/24, (x) KO255/24, (xi) KO256/24, (xii) KO257/24, (xiii) KO258/24, (xiv) KO259/24 dhe (xv) KO260/24, përfshi edhe kërkesën KO261/24, shqyrtuar veçmas nga këto raste, nuk kemi të bëjmë me një amendament të vetëm të propozuar pak para votimit final, por me 16 (gjashtëmbëdhjetë) projektligje të ndara. Prej këtyre projektligjeve, 13 (trembëdhjetë) prej tyre, ku bën pjesë edhe Projektligji për Byronë Shtetërore, janë shqyrtuar në të njëjtën ditë, në parim dhe shqyrtimin e dytë, ndërsa 3 (tre) ligje të tjera janë shqyrtuar vetëm në shqyrtim të dytë.
188. Gjykata rikujton se neni 74 i Kushtetutës përcakton se deputetët e Kuvendit ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit. Kjo e drejtë, nuk mund të kuptohet thjesht si e drejtë për të qenë fizikisht i pranishëm në një seancë plenare të Kuvendit, por si e drejtë për të kontribuar përmbajtësisht në procesin e ligjërjes dhe të interesit më të mirë publik duke siguruar kualitet përmbajtësor të legjislacionit, si në kuptim të qartësisë ashtu edhe të parashikueshmërisë së ligjeve.
189. Përkitazi me këtë të fundit, Gjykata vendos theksin në atë se ky proces i miratimit të dymbëdhjetë (12) ligjeve ka pamundësuar përfshirje efektive të të gjithë deputetëve gjatë procedurës së shqyrtimit të tyre në komisionet përkatëse të përhershme dhe ato funksionale, dhe si rezultat i mosvënies në dispozicion dhe në kohë, kufizimi kohor ka pamundësuar edhe zhvillimin e debatit të mirëfilltë dhe përmbajtësor të Projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara në Kuvend. Thënë këtë, në seancën e 5 dhjetorit 2024, ku brenda të njëjtës ditë u miratuan dymbëdhjetë (12) projektligje – secili në lexim të parë dhe të dytë – funksioni i deputetëve u reduktua praktikisht në një votim formal, pa pasur mundësi reale për shqyrtim të përmbajtjes së projektligjeve, diskutim apo propozim të amendamenteve. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata duke afirmuar standardet dhe opinionet e lartcekura të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të Gjykatave Kushtetuese të vendeve tjera dhe të Komisionit të Venecias vlerëson se në rastin e miratimit të një numri kaq të konsiderueshëm të ligjeve, që në përmbajtjen e tyre rregullojnë çështje me shumë rëndësi për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe fushëveprimi i tyre, ndër tjerash ndërlidhet edhe me aspekte të rëndësishme që afektojnë sistemin e drejtësisë dhe të sundimit të ligjit (shih Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale), konsultimet gjithëpërfshirëse janë thelbësore për të garantuar një kornizë ligjore kualitative dhe të zbatueshme në shërbim të interesit publik të Republikës së Kosovës.
190. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton konstatimin e Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, e cila në vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurës së miratimit të ligjit të kontestuar në procedurë të përsheptuar, kishte theksuar se “...*debati parlamentar dhe kërkesa kushtetuese që ligjet të shprehin vullnetin e deputetëve janë të lidhura ngushtë.*” Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë vlerësoi se shkelja e Rregullores së punës mund të rezultojë në konsekuenca kushtetuese, nëse, për shembull, debati dhe mundësia për deputetët që të marrin një qëndrim publik dhe shprehin pikëpamjet e tyre për një projektligj, kufizohen rëndë ose plotësisht, ose nëse do të kishte një numër mangësish në

të gjithë procedurën e cila në fund d+o të kishte të njëjtin efekt (shih, [vendimin PL. 13/2022-337 e Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë](#), cituar më lart). Edhe, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë kishte konstatuar se propozimi i amendamenteve të rëndësishme vetëm pak para votimit final të Ligjit për Lirinë e Fesë dhe Komunitetet Fetare, ka cenuar garancitë procedurale të procesit legjislativ dhe të ushtrimit të funksionit të deputetëve me arsyetimin se edhe nëse nuk ekziston ndonjë afat i saktë i paraparë për paraqitjen e amendamenteve, është vetë parimi i shtetit të së drejtës dhe i parlamentarizmit funksional që kërkon që deputetët të kenë kohë të mjaftueshme për të analizuar, shqyrtuar dhe reflektuar mbi ndryshimet që u kërkohej të votojnë.

191. Marrë parasysh dispozitat kushtetuese përkitazi me përcaktimin e detyrimit dhe të drejtës së deputetëve që të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, praktikën gjyqësore të vet Gjykatës, dhe atë të gjykatave kushtetuese të vendeve tjera, si dhe standardet e vendosura në Rregulloren e Kuvendit nga vetë deputetët, në funksion të ushtrimit të funksionit të deputetit, Gjykata konsideron se (i) Vendimi për shmangien e afateve procedurale, duke iu përcaktuar deputetëve dhe komisioneve parlamentare, afate në kohëzgjatje prej gjithsej 20 (njëzet) minutave, respektivisht 5 (pesë) – 10 (dhjetë) minuta për secilin komision parlamentar, (ii) Vendimet për miratimin e 12 (dymbëdhjetë) Ligjeve, të nxjerra në po të njëjtën ditë kur u edhe u shqyrtuan dhe u miratuan në shqyrtim të parë dhe të dytë, iu ka pamundësuar deputetëve dhe komisioneve ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues dhe rrjedhimisht janë nxjerrë në kundërshtim me (i) parimet dhe përcaktimet kushtetuese që burojnë nga nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës dhe (ii) të drejtat dhe detyrimet gjatë ushtrimit të funksionit të deputetëve të përcaktuar me nenin 74 të Kushtetutës, dhe (iii) procedurën dhe rregullat e miratimit të ligjeve sipas neneve 76 dhe 77 të Kushtetutës.
192. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore që ndërlidhet me procedurën e miratimit të ligjeve në Kuvend, sërish rritet që ushtrimi i pushtetit legjislativ, funksioni parësor i të cilit është procesi ligjvënës, nuk mund të reduktohet vazhdimisht në përcaktimet e nenit 123 të Rregullores së Kuvendit, përmes të cilit 2/3 (dy të tretat) e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë mund të vendosin të anashkalojnë të gjitha afatet procedurale të së njëjtës rregullore, duke përfshirë shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të cilat rregullojnë çështje me rëndësi apo edhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë prekin interesin publik, funksionimin e institucioneve shtetërore dhe të drejtat dhe liritë e individëve. Thënë këtë, Gjykata rritet që rëndësinë e faktit se e drejta e ushtrimit të funksionit të deputetit të Kuvendit në procedurën e shqyrtimit dhe miratimit që ndërlidhen me kompetencën legjislative të Kuvendit nënkupton edhe detyrimin e tij për prani dhe votim gjatë gjithë procesit, në të cilin deputetit i mundësohet një përfshirje dhe kontribut i drejtpërdrejtë në një proces të rregullt legjislativ transparent dhe gjithëpërfshirës dhe i cili i shërben interesit më të mirë publik.
193. Si përfundim, Gjykata konstaton se Vendimet e kontestuara të Kuvendit nuk janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 74 [Ushtrimi i funksionit]; 76 [Rregullorja e punës]; dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës.
194. Në fund, Gjykata rikujton se në kontekst të kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur për miratimin e 12 (dymbëdhjetë) Ligjeve të miratuara në lexim të parë dhe të dytë, parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se caktimi i seancës plenare përmes Vendimit për shmangie nga afatet procedurale cenon kompetencën kushtetuese të Kryetarit të Kuvendit për të thirrur seancat e Kuvendit sipas nënparagrafit 2 të paragrafit

7 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës dhe Kryesisë së Kuvendit sipas paragrafit 1 të nenit 19 (Detyrat e Kryesisë) të Rregullores së Kuvendit. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që vendimet e lartcekura të Kuvendit nuk janë në përputhje me nenet 4 [Forma e qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me nënparagrafin 2 të paragrafit 7 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.

(ii) Vlerësimi i procedurës së miratimit të tre (3) Projektligjeve, në seancat e 5 dhjetorit 2024, në lexim të dytë

A. Pretendimet e parashtruesve të kërkesave dhe kundërargumentet e palëve të interesuara

195. Gjykata rikujton se lidhur me Vendimet e kontestuara të Kuvendit përkitazi me shqyrtimin e dytë të (i) Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; (ii) Projektligjit për Bankat; dhe (iii) Projektligjit për Gjykatën Administrative, parashtruesit e kërkesave pretendojnë se procedura e miratimit të tyre nuk është në përputhje me nenet 74 [Ushtrimi i funksionit] dhe 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës. Po ashtu, parashtruesit e kërkesave theksojnë se nuk është respektuar afati kohor prej 72 (shtatëdhjetë e dy) orësh nga paragrafi 4 i nenit 68 (Seanca e jashtëzakonshme) të Rregullores së Punës së Kuvendit për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme pas dorëzimit të kërkesës lidhur me të.
196. Në anën tjetër, Kryetari i Komisionit për Legjislacion pretendon se vendimet e kontestuara të Kuvendit janë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe se pretendimet e parashtruesve të kërkesave janë qartazi të pabazuara dhe nuk ngrenë çështje kontestuese.

B. Vlerësimi i Gjykatës

197. Gjykata ve theks në faktin se, në seancën e 5 dhjetorit 2024, Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, Projektligji për Gjykatën Administrative dhe Projektligji për Bankat, janë shqyrtuar vetëm në lexim të dytë, ndryshe nga Projektligjet e tjera të lartcekura që u shqyrtuan dhe miratuan në të njëjtën ditë, në lexim të parë dhe të dytë. Gjykata rikujton se, për dallim nga dymbëdhjetë (12) projektligjet e lartcekura, ku deputetët kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur gjatë miratimit të tyre, me pretendimin se procedura e ndjekur është në kundërshtim me kërkesat e neneve 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e Punës] dhe 77 [Komisionet], në rastin e miratimit të tre (3) Ligjeve në lexim të dytë, parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës së miratimit të tre (3) ligjeve, me pretendimin se njëjta është në kundërshtim vetëm përkitazi me kërkesat e neneve 74 [Ushtrimi i funksionit] dhe 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës.
198. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se lidhur me (i) Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, më 5 dhjetor 2024, Kuvendi me vendim paraparak të kryesisë, ka caktuar seancën plenare e cila ka përmbajtur 28 pika në rendin e ditës, por i cili rend i ditës nuk përfshinte ende shqyrtimin e dytë të projektligjit të lartcekur. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Grupit Parlamentar të LVV-së, znj. Mimoza Kusari Lila, në emër të gjashtë (6) deputetëve të shumicës parlamentare ka parashtruar mocionin për plotësimin

e rendit të ditës, duke propozuar që projektligji në fjalë, të shqyrtohet si pikë e pestë (5) e seancës.

199. Gjykata, gjithnjë bazuar në shkresat e lëndës vëren se përveç (i) Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, Kryetarja e Grupit Parlamentar të LVV-së, znj. Mimoza Kusari Lila, në emër të gjashtë (6) deputetëve të shumicës parlamentare, ka parashtruar mocion për plotësimin e rendit të ditës, duke propozuar që tani edhe (ii) Projektligji për Bankat, të shqyrtohet si pikë e katërt (4) e seancës.
200. Gjykata, rikujton se për dallim nga 12 (dymbëdhjetë) projektligjet e lartcekura, në rrethanat e rastit konkret, në seancën plenare të 5 dhjetorit 2024, është bërë plotësimi i rendit të ditës, por për shqyrtim të projektligjeve, vetëm në lexim të dytë.
201. Gjykata, tutje rikujton se edhe sipas nenit 78 të Rregullores së Kuvendit, përcaktohet se shqyrtimi i dytë fillon me paraqitjen e raportit të Komisionit përgjegjës-raportues. Gjatë kësaj seance, të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, të grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët. Në këtë fazë nuk mund të propozohen amendamente të reja, përveç nëse ka nevojë për evitimin e kolizionit ndërmjet dispozitave të projektligjit. Në këto raste, shqyrtimi mund të ndërpritet dhe të kthehet në komision për trajtim të mëtejshëm. Pas përfundimit të shqyrtimit dhe votimit të amendamenteve të propozuara, votohet teksti i plotë i projektligjit me amendamentet e miratuara.
202. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa për plotësim të rendit të ditës për shqyrtimin e dytë të projektligjeve të sipërcituara është bërë, sepse (i) Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut ishte miratuar në parim në lexim të parë, në seancën plenare të 16 maj 2024, përmes Vendimit Nr. 08 - V - 722 dhe (ii) Projektligji për Bankat ishte miratuar në parim në lexim të parë përmes Vendimit Nr. 08 - V - 772, në seancën plenare të 11 korrikut 2024.
203. Duke u kthyer në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se sipas Rregullore së Kuvendit, pas leximi të parë, projektligjet kanë kaluar në komisione, të cilat kanë pasur afatet e tyre, dhe ato afate kanë kaluar. Pas kësaj faze, propozimet me automatizëm iu dërgohen deputeteve. Në rrethanat konkrete, përkritazi me Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Projektligjin për bankat, kjo ka ndodhur dhe se deputetët kanë pasur kohë të mjaftueshme për të dhënë mendimin e tyre përkritazi me këto projektligje, respektivisht ligje të miratuara në lexim të dytë.
204. Gjykata vlerëson se, në rrethanat konkrete, plotësimi i rendit të ditës për shqyrtimin e projektligjeve të lartcekura dhe mosshpërndarja e materialeve siç përcaktohet me nenin 52 të Rregullores së Punës së Kuvendit, nuk ka ndikuar në thelb në ushtrimin e funksionit përfaqësues të deputetëve të përcaktuar me nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] apo edhe nuk ka cenuar apo shmangur shqyrtimin e rregullt legjislativ në shqyrtimin e parë apo edhe afatet dhe punën e komisioneve, përcaktuar në Rregulloren Kuvendit, në kuptim të nenit 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës.
205. Tutje, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave kanë kontestuar edhe procedurën e ndjekur për miratimin e Ligjit për Gjykatën Administrative, në shqyrtimin e dytë. Mirëpo për dallim nga ligjet e lartcekura, të cilat kanë qenë pjesë shqyrtimit të dytë në seancë të rregullt plenare përmes thirrjes për plotësim të rendit të ditës, Ligji për Gjykatën

Administrative ka qenë pjesë e shqyrtimit të dytë, përmes thirrjes së Seancës së Jashtëzakonshme.

206. Sipas shkresave të lëndës, deputeti Adnan Rrustemi nga Grupi parlamentar Lëvizja Vetëvendosje!, në emër të deputetëve nënshkrues, përmes shkresës [08-6058-DO6053] i propozoi Kryetarit të Kuvendit thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 5 dhjetor 2024, në orën 20:10, për shqyrtimin në lexim të dytë të Projektligjit për Gjykatën Administrative.
207. Është e rëndësishme të theksohet se seanca e Jashtëzakonshme e 5 dhjetorit 2024 është thirrur me kërkesë të një të tretave (1/3) të deputetëve. Sipas paragrafit 4 të nenit 68 (Sanca e jashtëzakonshme), përcaktohet se “Sanca e jashtëzakonshme mbahet jo më vonë se 72 orë nga momenti i dorëzimit të kërkesës në Zyrën për propozime dhe parashtresa. Kohën e mbajtjes e përcakton thirrësi i seancës. Sipas parashtresave të lëndës vërehet se parashtresit e kërkesave nuk e kontestojnë mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme, sepse e njëjta u mbajt në të njëjtën ditë, kur u paraqit kërkesa, por kontestojnë mocionin procedural mbi bazën e nenit 123 për shmangien nga afatet procedurale lidhur me nenin 52, përkatësisht të detyrimit për t’iu dërguar deputetëve rendin e ditës dhe materialet e seancës, se paku dy (2) ditë pune me herët.
208. Gjykata vëren se në rastin konkret, nuk kontestohet kushtetutshmëria e mbajtjes së Seancës së Jashtëzakonshme, por se materialet për shqyrtimin e dytë të projektligjit nuk u janë shpërndarë deputeteve dy (2) ditë pune me herët.
209. Gjykata vlerëson se pretendimi për shkelje të nenit 74 të Kushtetutës [Ushtimi i funksionit], nuk qëndron në thelb, pasi që nga momenti i miratimit të Projektligjit për Gjykatën Administrative në lexim të parë më 4 prill 2024, deri në shqyrtimin e dytë të tij më 5 dhjetor 2024 ka ekzistuar një periudhë kohore më shumë se tetë muaj. Kjo periudhë ka ofruar kohë të mjaftueshme për komisionet parlamentare që të kryejnë shqyrtimin e projektligjit dhe për deputetët që të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë aktive dhe në përputhje me nenin 74 [Ushtimi i Funksionit], ndërlidhur me nenin 76 [Rregullorja e Kuvendit] të Kushtetutës.
210. Për më tepër, Gjykata vë në dritë paragrafin 2 të nenit 78 [Shqyrtimi i dytë i Projektligjit] të Rregullores së Kuvendit, ku me këtë nen është vënë përcaktimi ligjor se “*Gjatë shqyrtimit të dytë në seancë plenare nuk mund të propozohen amendamente të reja, me përjashtim të rastit kur paraqitet nevoja për të evituar kolizionin e dispozitave të projektligjit...*”.
211. Si përfundim, Gjykata konstaton se Vendimet e kontestuara të lartcekura të Kuvendit, përmes të cilave u miratuan (i) Ligji për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, (ii) Ligji për Bankat dhe (iii) (i) Ligji për Gjykatën Administrative, janë në përputhshmëri me nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 74 [Ushtimi i funksionit]; dhe 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës.

IV. Përkitazi me kërkesën për pezullim *Ex- Lege*

212. Gjykata rikujton se parashtresit e kërkesave kanë kërkuar pezullimin *ex-lege*, me qëllim të parandalimit të zbatimit të ligjeve të kontestuara, deri në sjelljen e vendimit përfundimtar lidhur me kërkesat në fjalë.

213. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 (Afati) të Ligjit, e përcakton efektin pezullues të hyrjes në fuqi të ligjeve të cilat kontestohen në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*.
214. Bazuar në dispozitën e sipërpërmendur, më 13 dhjetor 2024, Gjykata ka kërkuar nga Presidentja, Kryetari i Kuvendit, dhe Zv. Sekretari i Kuvendit të marrin parasysh kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, dhe për rrjedhojë, hyrja në fuqi e ligjeve të kontestuara, *ex-lege*, është pezulluar deri në vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 113. 5 dhe 116. 2 të Kushtetutës, në nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 12 nëntor 2025:

VENDOS

- I. TË SHPALLË, njëzëri kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me pesë (5) vota për dhe dy (2) kundër që: (i) Vendimet [Nr. 08-V-801] dhe [Nr. 08-V-848] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave; (ii) Vendimet [Nr. 08-V-806] dhe [Nr. 08-V-854] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport; (iii) Vendimet [Nr. 08-V-800] dhe [Nr. 08-V-847] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; (iv) Vendimet [Nr. 08-V-802] dhe [Nr. 08-V-849] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore; (v) Vendimet [Nr. 08-V-795] dhe [Nr. 08-v-842] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-315 për Banim Social dhe të Përbalueshëm; (vi) Vendimet [Nr. 08-V-797] dhe [Nr. 08-V-845] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr.08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (vii) Vendimet [Nr. 08-V-796] dhe [Nr. 08-V-843] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; (viii) Vendimet [Nr. 08-V-807] dhe [Nr. 08-V-855] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale; (ix) Vendimet [Nr. 08-V-805] dhe [Nr. 08-V-853] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; (x) Vendimet [Nr. 08-V-804] dhe [Nr. 08-V-851] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore; (xi) Vendimet [Nr. 08-V-803] dhe [Nr. 08-V-852] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; dhe (xii) Vendimet [Nr. 08-V-799] dhe [Nr. 08-V-846] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare, nuk janë në përputhshmëri me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 74 [Ushtrimi i funksionit], 76 [Rregullorja e punës] dhe 77 [Komisionet] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË KONSTATOJË, njëzëri, që: (i) Vendimi [Nr. 08-V-821] i 5 dhjetorit 2024 i Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat; (ii) Vendimi [Nr. 08-V-822] i 5 dhjetorit 2024 i Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 07/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; dhe (iii) Vendimi [Nr. 08-V-850] i 5 dhjetorit 2024 i Kuvendit, përmes të cilit është miratuar Ligji Nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative; që të gjitha, janë në

përputhshmëri me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 74 [Ushtrimi i funksionit] dhe 76 [Rregullorja e punës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

- IV. TË SHFUQIZOJË, me pesë (5) vota për dhe dy (2) kundër, (i) Vendimet [Nr. 08-V-801] dhe [Nr. 08-V-848] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave; (ii) Vendimet [Nr. 08-V-806] dhe [Nr. 08-V-854] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport; (iii) Vendimet [Nr. 08-V-800] dhe [Nr. 08-V-847] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; (iv) Vendimet [Nr. 08-V-802] dhe [Nr. 08-V-849] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore; (v) Vendimet [Nr. 08-V-795] dhe [Nr. 08-v-842] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-315 për Banim Social dhe të Përballueshëm; (vi) Vendimet [Nr. 08-V-797] dhe [Nr. 08-V-845] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-321 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (vii) Vendimet [Nr. 08-V-796] dhe [Nr. 08-V-843] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-320 për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; (viii) Vendimet [Nr. 08-V-807] dhe [Nr. 08-V-855] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale; (ix) Vendimet [Nr. 08-V-805] dhe [Nr. 08-V-853] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; (x) Vendimet [Nr. 08-V-804] dhe [Nr. 08-V-851] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-324 për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore; (xi) Vendimet [Nr. 08-V-803] dhe [Nr. 08-V-852] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore; dhe (xii) Vendimet [Nr. 08-V-799] dhe [Nr. 08-V-846] e 5 dhjetorit 2024 të Kuvendit, përmes të cilëve është miratuar Ligji Nr. 08/L-334 për Lojërat Mesdhetare.
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- VI. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Nexhmi Rexhepi